

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE - DEPARTAMENTI SPECIAL, me Trupin Gjykes në përbërje nga gjyqtarja Valbona Musliu-Selimaj – Kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarët Valon Kurtaj dhe Suzana Çerkini - Anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arbnore Idrizi, në çështjen penale kundër të akuzuarit: Z. V. për veprën penale në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur të njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat e tjerë të armatosur dhe të uniformuar, Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës<sup>1</sup>, PPS.nr.09/2018, të datës 06 mars 2020, pas mbajtjes së një sërë shqyrtimesh gjyqësore të mbyllura për publikun, me datë 15.06.2020, 21.01.2021, 22.01.2021, 25.02.2021, 01.03.2021, 24.03.2021, 01.04.2021 dhe me datën 30.06.2021, në prezencën e Prokurores së PSRK-së, Drita Hajdari, të akuzuarit Z. V me mbrojtësin e tij Avokat, N. V. sipas detyrës zyrtare, të dëmtuarës – dëshmitare D.1 me përfaqësuesen e saj me autorizim Avokate, Sh. R. – B, ndërsa komfor nenit 366 të KPPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor pas tri ditësh, me datë **05 korrik 2021** mori dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari : Z. V. nga i ati D. dhe nënës P. e gjinisë M. i lindur me data e lindjes..., në Mitrovicë, me vendbanim në Republika e Malit të Zi, ka të kryer shkollën e mesme juridike - biroteknike, i shkurorëzuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i nacionalitetit serb, shtetas i Republikës së Serbisë, ish pjesëtar i forcave policore në Stacionin Policor Vushtrri, aktualisht në vuajtje të dënimit në Burgun e Sigurisë së Lartë në Dyz, sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.54/17, i datës 25 maj 2018.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: I akuzuari, Z.V. si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në muajin maj të viti 1999 gjatë luftës në Kosovë, në kundërshtim me rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare gjatë një sulmi të gjerë nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, kundër popullatës civile shqiptare në territorin e Komunës së Vushtrrisë, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të këtij njësi, mori pjesë në dëbimin e popullatës civile shqiptare, në kryerjen e dhunës fizike dhe psikike ndaj tyre si dhe me përdorimin e dhunës dhe veprimeve të tjera çnjerëzore, ka kryer dhunim seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar në atë mënyrë që :

Me datën 22 maj të vitit 1999, tek varreza e Vushtrrisë, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në mesin e të cilëve edhe i akuzuari Z.V. tubuan popullatën civile shqiptare që më parë ishin dëbuar nga vendbanimet e tyre i urdhëruan të ulen të tokë dhe për derisa ishin në atë pozitë, i akuzuari me një mjet- shkop të drurit fillon ti rrahë duke i goditur në kokë dhe pjesë të ndryshme

---

<sup>1</sup> Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në tekstin e më tejme të këtij aktgjykimi e referuar si PSRK.

të trupit dhe në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të njësitit të përmendur i ndajnë meshkujt e rinj, i ngarkojnë me kamionë dhe i largojnë nga vendi në drejtim të panjohur, ndërsa gratë, fëmijët dhe pleqtë i detyrojnë të presin në kolonë para një shtëpie dykatëshe, kinse për ti pajisur me kartela të identifikimit dhe me të ardhur rendi tek e dëmtuara D.1 i akuzuari e mori me forcë duke e futur në një dhomë në katin e dytë të asaj shtëpie ku kishte edhe femra të tjera të zhveshura dhe të dhunuara nga disa polic, ku në prezencën e atyre femrave dhe policëve të tjerë i akuzuari përplasi të dëmtaren për dysheme, me forcë ia shqyen rrobat dhe kryen aktin seksual - dhunimin së bashku edhe me një polic tjetër deri tani i paidentifikuar, i cili përderisa i akuzuari Z. e dhunonte, polici tjetër i paidentifikuar ia mbyllte gojën, e kafshonte dhe ia shtrëngonte gjokset, ndërsa në momentin kur e dëmtuara nga dhimbje kthehet me trup anash, i akuzuari Z. e godet me shqelm në pjesën e kurrizit nga e cila goditje kishte humbur vetëdijen, ku e dëmtuara në kohën e dhunimit ishte shtatzënë në muajin e tretë, kurse në shtator të po atij viti kishte pësuar abort ku ka humbur dy foshnje binjake të gjinisë mashkullore dhe pëson trauma të rënda fizike dhe psikike.

- Me këto veprime i akuzuari në bashkëkryerje me pjesëtar të tjerë të panjohur të njësitit rezervist të policisë serbe dhe pjesëtar të tjerë të armatosur dhe të uniformuar ka kryer veprën penale, Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Andaj, gjykata komfor neneve 1; 4; 5; 8; 11; 13; 25; 33; 34; 35; 38; 41 dhe nenit 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë si dhe komfor neneve 359; 360; 361 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të akuzuarit i shqipton:

## **DËNIM ME BURGIM**

- Në kohëzgjatje prej 10 vite, të cilin dënim do ta vuan në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Obligohet i akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguajë shpenzimet aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind Euro (100 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë Euro (50 €), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- E dëmtuara, përmes përfaqësueses së saj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregull civil.

## **A r s y e t i m**

### **Historiku procedural:**

Me datë 05 Gusht 2019, PSRK ka filluar hetimet kundër të akuzuarit Z. V. për veprën penale, Krime lufte kundër popullsisë civile, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), lidhur me nenin 3 të Konventës së Katërt të Gjenevës, e penalizuar me nenin 145 Krimet e luftës në shkelje të rënde të ligjeve dhe zakoneve që zatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar par.1 nënpar. 2 lidhur me par.2 nënpar. 2.1; 2.21; 2.22 dhe nenin 144 Krimet e luftës në shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës , par.1 nënpar.1.2 lidhur me par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 06 mars 2020, PSRK ka ngritur aktin akuzues nën numrin PPS.nr.09/2018, kundër të akuzuarit Z.V. për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje me pjesëtarët e tjerë të panjohur njësitit të përmendur rezervist të policisë serbe dhe personat tjerë të armatosur dhe të uniformuar ka kryer veprën penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit penal të Republikës Socialiste Federativetë Jugosllavisë, aktualisht e inkriminuar si Krimet kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nënpar.1.4;1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Gjykata Themelore – Departamenti Special, duke vepruar sipas aktit akuzues të lartë-theksuar me datën 15.06.2020, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, ku i akuzuari në praninë e mbrojtësit të tij e ka mohuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndërsa lidhur me kërkesën e mbrojtësit të të akuzuarit për hudhje të aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale, sepse ekzistojnë rrethana që e ndalojnë ndjekjen penale, gjykata jashtë seancës, pa mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, me Aktvendim PS.nr.15/20,të datës 07 gusht 2020, ka refuzuar kërkesën për hedhjen e aktit akuzues të të akuzuarit, respektivisht të mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Vendimin nën numrin PNS.nr.37/2020, të datës 18 shtator 2020, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit Z. V. av. N. V. të ushtruar ndaj Aktvendim PS.nr.12/2020 me të cilin është refuzuar kërkesat për hedhjen e aktit akuzues dhe të njëjtin vendim e ka lënë në fuqi.

Pasi që aktakuza ka marr formën e prerë, Gjykata Themelore - Departamenti Special në Prishtinë, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me procedimin e çështjes penale duke i administruar provat që ndërlidhen me këtë vepër penale, provat materiale dhe me dëgjimin e dëshmisë së të dëmtuarës – dëshmitare D.1, me dëgjimin e dëshmisë së dëshmitarëve sipas radhës së paraqitjes së tyre në shqyrtim gjyqësor, të mbajtur me datat: 15.06.2020; 21.01.2021; 22.01.2021; 25.02.2021; 01.03.2021; 24.03.2021; 01.04.2021 dhe me datën 30.06.2021, ndërsa me datë 05 korrik 2021 është shpallur edhe ky aktgjykim.

### **Fjala përfundimtare e palëve:**

Prokurorja e PSRK-së, Drita Hajdari, në fjalën e saj përfundimtare, deklaroj se mbetet pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim, duke theksuar se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues kundër të akuzuarit Z.V. ngase me provat materiale dhe atyre personale të administruara gjatë kësaj

çështjeje penale është vërtetuar pa mëdyshje fakti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen elementet esenciale të veprës penale për të cilën akuzohet.

Me datë 24.03.1999, me të filluar Operacioni Ushtarak i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, me qëllimin e ndalimit të abuzimeve të të drejtave të njeriut, me atë datë Republika Federative e Jugosllavisë kishte shpallur zyrtarisht gjendjen e luftës në tërë territorin e Kosovës, ku gjatë luftës në Kosovë u kryen krime të tmerrshme ndaj civilëve të pafajshëm shqiptar, në mesin e tyre edhe krime të dhunës seksuale ndaj femrave shqiptare.

Si prova të administruara e të cilat dëshmojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, ka përmendur dhe analizuar :

Me dëshminë e të dëmtuarës - dëshmitare D.1, e cila si gjatë procedurës hetimore, por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e cila ka përshkruar në tërësi ngjarjen që kishte ndodhur gjatë muajit maj të vitit 1999 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, saktësisht me datën 22 maj të vitit 1999, tek varrezat e Vushtrrisë, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, në mesin e tyre edhe i akuzuari Z. V. i veshur me uniformën e policisë rezervë dhe i armatosur, pasi që kishin tubuar popullatën civile shqiptare që më parë ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre, i kishin rreshtuar para një shtëpie dy katëshe kinse për ti pajisur me kartela identifikimi dhe posa i kishte ardhur rendi i saj, i akuzuari Z. V. ia kishte larguar vajzën nga krahu dhe e kishte futur në një dhomë në katin e dytë të asaj shtëpie ku i ndihmuar edhe nga një polic serb e kishte dhunuar, e cila ishte shtatëzënë me dy binjak dhe gjatë aktit të dhunimit edhe e kishte shkëllmuar me shqelm i akuzuari, ku e dëmtuara me atë rast edhe kishte humbur vetëdijen, e kur i është kthyer vetëdija e ka gjetur vetën në korridorin e asaj shtëpie ku një polic e kishte goditur me këmbë duke e qitur jashtë asaj ndërtese dhe e dëmtuara ishte larguar prej aty dhe kishte shkuar tek familja e saj që ishte e strehuar në Vushtrri, te nëna motrat, vjehrra dhe dy vajzat e saja të vogla.

Mbrëmjen e asaj nate, të dëmtuarën nëna dhe vjehrra e saj e kishin dërguar tek mjeku A. V. në shtëpinë e tij në Vushtrri ku edhe kishte ordinancë i cili e kishte kontrolluar ai dhe doktoresha M.I. ku edhe kishin vërtetuar shenja – dëmtime në trupin e saj dhe gjakderdhje nga organet gjinitale, ku e dëmtuara, menjëherë ka përmendur emrin e të akuzuarit Z. V. se ishte personi i cili e kishte dhunuar dhe ka bërë edhe përshkrimin fizik të tij.

Nga dëshmia e dëshmitarit M. Xh. u vërtetua se edhe ai ishte në mesin e popullit të dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe të tubuar tek varrezat e Vushtrrisë, i cili ka vërtetuar prezencën e të akuzuarit Z. V. në vendin e krimit me datën 22 maj 1999, ku edhe ishin urdhëruar që të uleshin në tokë, ku derisa kishin qëndruar në atë pozitë i akuzuari Z. ia kishte marrë një shkop të drurit një qytetari civil shqiptar i cili mbahej për të dhe me atë shkop ka filluar që ti rrah civilët e ulur në tokë duke i goditur në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, ku kishte vazhduar ti godas derisa një polic tjetër ia ka larguar nga dora. Ky dëshmitar ka dëshmuar se forcat serbe pasi që i kanë ndarë meshkujt e rinj dhe i kanë larguar me kamion, pjesën tjetër të mbetur të civilëve shqiptar gratë, fëmijët dhe pleqtë i kanë rreshtuar në kolonë para shtëpisë së R. Xh.-vëllaut të tij për tu pajisur me kartela të identifikimit, ku edhe dëshmitari e kishte shtëpinë e tij ngjitur me të, e më vonë ka dëgjuar se aty ishin kryer dhunime dhe shtëpitë e tyre u djegën.

Nga dëshmia e dëshmitarit A. V. u vërtetua se i njëjti ishte me profesion mjek dhe gjatë periudhës së luftës ka qëndruar në shtëpinë e tij në Vushtrri që gjendej afër varrezave të qytetit, ku gjatë asaj kohe ka pranuar edhe shumë të sëmurë dhe të lënduar e në mesin e tyre edhe rastin e të dëmtuarës D.1 e cila ishte e dhunuar. I kujtohej se një femër e shoqëruar nga dy persona, i kishte shkuar në ordinancë për ndihmë mjekësore e cila ishte në gjendje të rëndë e shqetësuar dhe gjatë kontrollit mjekësor ka vërejtur në trupin e saj gërvishtje, hematome dhe kafshim me dhëmbë në pjesën e gjokseve, mavijosje, shkyerje në organet gjenitale, ku i kishte ofruar ndihmën mjekësore me antibiotik dhe sedativ, kurse kontroll sidomos në pjesët gjenitale i kishte bërë edhe doktoresha M. E cila punonte aty, të cilën e kishte ftuar doktor V. ku edhe kishin vërejtur lëndimet në tërë pjesët e trupit. Edhe kjo dëshmitare M. I. ka dëshmuar se ditën kritike në një hapësirë të varrezave të qytetit në Vushtrri forcat serbe, ushtarake, policore dhe paramilitare i kanë tubuar një numër të madh të popullsisë civile, burra, gra, fëmijë ku i kanë ndarë meshkujt të cilët i kanë ngarkuar me kamionë dhe i kanë dërguar në burgun e Smrekovnicës dhe në sallën e sportit të ura e gurit në Vushtrri, kurse gratë dhe fëmijët i kanë ndarë dhe i kanë dërguar në drejtim tjetër ku atë ditë edhe kishte ndodhur një masakër e madhe në shtëpinë e K. P.

Dhunën e shkaktuar ndaj të dëmtuarës e ka vërtetuar edhe dëshmia e dëshmitarit – mjekut, Sh. G. i cili kishte trajtuar shume viktime të dhunës seksuale, të kryera gjatë luftës në Kosovë, e në mesin e tyre edhe të dëmtuarën D.1 gjatë vitit 2013, ku e dëmtuara i kishte treguar se dhunuesi ishte Z. V.

Edhe nga dëshmia e lexuar e dëshmitares D. B. u vërtetua gjendja faktike, e cila ka sqaruar në detaje, se si ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre, se kishin qëndruar nëpër shtëpi të huaja, për një kohë dhe se i kishin tubuar në qytetin e Vushtrrisë dhe për ngjarjen e datës 22 maj të vitit 1999, tek varrezat e Vushtrrisë, e cila ishte së bashku me vajzat e saj duke pritur para shtëpisë dy katëshe për tu pajisur me kartela identifikimi, ku gjatë asaj kohe i janë marrë vajzat e saja ( D.1. 27 vjeçare dhe vajza tjetër 19 vjeçare), ku D.1, ishte kthyer në shtëpi po atë natë në gjendje tmerruese, shumë të rëndë, e shqyer dhe me shenja, dhe atë natë e kishin dërguar te mjeku, kurse vajza tjetër ishte kthyer të nesërmen, gati e zhveshur me lëndime në trup e shqetësuar dhe në gjendje shumë të rëndë.

E dëmtuara si pasojë e traumës së shkaktuar gjatë atij dhunimi, në vitin 2017 ka kërkuar edhe ndihmën e psikologëve dhe mjekëve nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, ku nga dëshmia e dëshmitares V. D. –Xh. me profesion mjekë, u vërtetua se e dëmtuara i është rrëfyer për traumën e shkaktuar të dhunës seksuale, emrin e dhunuesit, ndërsa dëshmitarja S. I. – Ç. – psikologe, ka dëshmuar për trajtimin e ofruar nga kjo qendër të dëmtuarës, e cila si pasojë e dhunës seksuale ka treguar simptoma të stresit postraumatik menjëherë pas rastit të nivelit të lartë të cilat simptoma me kalimin e kokës kanë pësuar ulje të intensitetit nga shifra 4 në shifrën 2, që është gjendja e saj aktuale, e cila përkundër trajtimit të vazhdueshëm ende nuk e ka tejkaluar çrregullimin e stresit postraumatik, që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në mirëqenien e saj fizike dhe psikike.

Prokurorja, përveç provave personale ka potencuar edhe provat materiale, e të cilat janë administruar gjatë kësaj çështjeje penale me të cilat është vërtetuar fakti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen elementet esenciale të veprës penale për të cilën akuzohet, e si prova të administruara e të cilat dëshmojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit prokurorja ka përmendur

dhe analizuar provat: Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitarja D.1, nga i cili procesverbal e dëmtuara e ka njohur kryesin e veprës penale, Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitari M. Xh. ku vërtetohet se i akuzuari është identifikuar në mesin e fotografisë të cilat i janë prezantuar dëshmitarit; fotoalbumi nga vendi i ngjarjes dhe skicimi i vendit të ngjarjes që dëshmojnë vendin ku ndodhi ngjarja e datës 22 maj 1999; raportet mjekësore për të dëmtuarën D.1, të cilat dëshmojnë se i është nënshtruar kontrolleve dhe intervenimit në kurriz, ku me rastin e dhunimit nga i akuzuari është shqelmuar me shqelm në kurriz; Shkresa nga Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës, ku vërtetohet faktin se e njëjta e ka fituar statusin e kësaj kategorie.

I akuzuari Z. V. para luftës në Kosovë ka punuar në Gjykatën Komunale në Vushtrri dhe bazuar kësaj pune edhe është njohur nga qytetarët e atij rrethi. E dëmtuara D.1, të akuzuarin e kishte parë edhe në kolonën e të dëbuarve në fshatin ... Komuna e Vushtrrisë, në ditën kur në fshat u vranë shumë civil shqiptar, rasti i njohur si "M. e S.", për të cilin rast i akuzuari është në procedurën e rigjyimit si dhe në Kooperativën Bujqësore në Vushtrri, derisa bashkë me shumë qytetarë tjerë të Vushtrrisë e kishin kaluar natën, e pa edhe në korridorin e shtëpisë së R. Xh. ku derisa kishte pritur në kolonë, kishte dëgjuar fjalët nga të pranishmit se aty është Z. V. është shumë i rrezikshëm dhe dëshmitarja ishte e sigurve se krimin ndaj saj e ka kryer i akuzuari Z. V.

E dëmtuara D.1 të akuzuarin e njohu dhe e identifikoi edhe përmes fotografisë në fotoalbum, të njëjtin e identifikoi edhe gjatë gjyqimit, andaj bazuar në faktin se dëshmia e saj sa i përket krimit dhe identitetit të kryesit në kontinuitet është e pandryshueshme dhe konsekuente, qysh nga dita e parë e krimit deri më sot, identiteti i të akuzuarit Z. V. si kryes i veprës penale është vërtetuar në mënyrë të sigurve.

Vepra penale për të cilët ngarkohet i akuzuari Z. V. është kryer me datë 22 maj 1999 në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, Midis Forcave të Armatosura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Serbisë, pas fillimit të bombardimeve të NATO-s ( 24 mars 1999), me datë 24 mars të vitit 1999 RFJ shpalli gjendjen e luftës që është shtrirë në territorin e Kosovës deri me 19 qershor 1999. I akuzuari ishte i vetëdijshëm për ekzistimin e konfliktit të armatosur, ishte pjesëtar i njësisë rezervë policore të MPB/MUP të Serbisë në Kohën kur Republika e Serbisë e kishte shpallur gjendjen e luftës dhe me dashje dhe dijeni ka dhunuar gruan shqiptare në formën tejet të egër dhe poshtëruese.

Fakti se i akuzuari ishte pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarës D.1, nga dëshmitari M. Xh. të cilët e kanë parë të akuzuarin të veshur me uniformë policore dhe i armatosur, si dhe ky fakt është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.54/17, të datës 25.05.2018, ku vërtetohet se i akuzuari Z. V. në mes të datës 03 maj 1999 dhe fillim të qershorit 1999 ishte polic rezervë në Stacionin Policor të Vushtrrisë, e në këtë cilësi ka kryer veprën penale për krime të luftës kundër popullsisë civile, për të cilën veprë penale edhe u dënua me dënim me burgim 6 vite e 6 muaj, andaj në veprimet e të akuzuarit Z.V. janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale Krimet kundër njerëzimit, e cila veprë penale në kohën e kryerjes së veprës penale ishte në fuqi LP i RSFJ-së, i cili në Kreun XVI ka titulluar veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Ky ligj ka inkriminuar shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare ndaj popullatës civile gjatë luftës, ku janë

inkriminuar veprimet çnjerëzore, shkaktimi i vuajtjeve dhe dhimbjeve të mëdha, duke përfshirë edhe dhunimin, andaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin Z.V. ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit .

Mbrojtësi i të akuzuarit Z.V. Avokat N. V. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të deponuar me shkrim duke theksuar se luftërat janë gjëja me e keqe, më e dhimbshme në historinë njerëzore, e që me keqardhje edhe lufta në Kosovë nuk ka qenë ndryshe, se edhe vet është qytetar i Kosovës dhe i vjen keq për vuajtjet dhe dhimbjet e të dëmtuarës në këtë rast.

Mbrojtja deklaroi se, aktakuza e Prokurorisë është ngritur kundërligjshëm, në mënyrë paushalle, pa asnjë provë dhe e njëjta nuk është dashur të jetë çështje e gjykimit, por është dashur që të hudhet, ngase pa drejtësisht dhe në mënyrë të paligjshme prokuroria në aktakuzë ka shënuar “me qëllim të dhunimit, si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar “, e që për këtë nuk ka asnjë provë e një konstatim të tillë të prokurorisë nuk e konfirmon asnjë gjykim në asnjë gjykatë në Kosovë, një konstatim i një sulmi të gjerë është qëllim keq sepse të pandehurin e vë në pozitë më të vështirë se që është. Nuk vërtetohet se raste të dhunë seksuale ndaj gruas shqiptare gjatë kohës së luftës nuk ka pasur, por pa një aktgjykim dhe pa asnjë provë të vetme të konstatohet diçka e tillë është e palejueshme dhe deri sa kjo nuk vërtetohet ky është rasti i parë i kësaj në Kosovë, i pa lejuar, jo objektiv e i përkrahur edhe nga gjykata ngase një aktakuzë të tillë e ka lënë në fuqi.

Përkundër konstatimit të paargumentuar për dhunim të një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër gruas së nacionalitetit shqiptar, në aktakuzë ka edhe shumë të paargumentuara gjë që mbrojturit të tij i vështirësohet pozita, e që pjesë e këtij konstatimi është se, pasojë e dhunimit 4 muaj prej ngjarjes, e dëmtuara ka pësuar abort dhe i ka humbur binjakët e gjinisë mashkullore, gjë që është e dhimbshme, por nuk ka asnjë dëshmi që ka lidhje me ngjarjen e ndodhur.

Vepra penale nuk mundet të kualifikohet apo të dënohet sipas Kodit të ri penal i cili është më i rëndë, të akuzuarit i vihet në barrë që ka kryer veprën penale, Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së, por prokurori gabimisht dhe në mënyrë kundërligjore thekson se kjo veprë penale është e ndëshkueshme si krime kundër njerëzimit nga neni 143 par.1 nënpar.1.4; 1.6 dhe 1.7 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me konstatimin se mund të aplikohet ligji penal i Kosovës i cili parasheh dënim shumë më të rreptë se sa ligji penal i RSFJ-së që i sugjeron gjykatës që V. mund ti shqiptoj dënim prej 25 vite burg apo burgim të përjetshëm e që nuk është e vërtetë. Vepra penale është kryer gjatë periudhës së luftës në Kosovë 1999 dhe mund të gjykohet vetëm me ligjin i cili ka qenë në fuqi në atë kohë dhe që ai ligj është më i butë, andaj edhe ky kualifikim juridik duhet të hudhet prej dispozitivit të aktakuzës sepse të pandehurin e vë në situatë shumë më të rëndë nga ajo në të cilën gjendet ai.

Udhëheqja e më shumë procedurave për krime lufte është e palejueshme. Kundër të mbrojturit të tij janë duke u udhëhequr rreth 4 procedura penale për krime të luftës, të njëjtës kohë dhe për veprën penale të njëjtë, të njëjtës natyrë e që edhe ka propozuar që procedura të bashkohet, por një propozimi i tillë është refuzuar, ndërsa është dashur të udhëhiqet vetëm një procedurë penale e bashkuar dhe ti shqiptohet vetëm një dënim.

Propozimi i provave në shqyrtimin gjyqësor e jo në aktakuzë nuk është i lejuar, gjykata ka bërë shkelje të rëndë, të kodit të procedurës penale dhe garantimin e një gjykimi të drejtë, ku prokurorja në fund të shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që të administrohen si prova e që më herë në aktakuzë nuk i ka përmend asnjë dhe nuk i ka propozuar cilat prova të administrohen në shqyrtimin gjyqësor. Propozimi i çfarëdo provave në këtë fazë të procedurës është i palejuar dhe është dashur të refuzohet, ngase ligji është i qartë, në bazë të nenit 241 pika 1.6 të KPPRK-së, parasheh që aktakuza të përmbajë propozimin me prova të cilat duhet të administrohen gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor situata është e qartë, provat e reja ose dëshmitarët mund të propozohet vetëm nëse nuk kanë qenë të njohura më parë në shqyrtimin e dytë dhe e drejta e të akuzuarit për një gjykim të drejtë mund të dëmtohet me refuzimin e kërkesës, e që këtu nuk është rasti, ngase të gjitha këto prova që prokurorja i ka propozuar kanë qenë me kohë të njohura qysh me ngritjen e aktakuzës dhe propozimi i tyre tani në këtë fazë nuk është në interes por në dëm të akuzuarit, ndërsa pretendimin e prokurores se është lëshuar një gabim teknik nuk i jep të drejtën që më vonë të propozoj çfarëdo prove tjetër e gjykata nuk është dashur ta aprovoj se ligji e ndalon, e lejimi i prezantimit të një morie provave që kanë ekzistuar ka herë por nuk janë prezantuar, bën të kuptojmë mohim për shpalesjen e provave në të cilat bazohet aktakuza, ndërsa prokurori duhet ti prezantoj më së voni para shqyrtimit fillestar, në këtë rast prova të reja nuk ka, prokuroria thirret në plotësimin e provave e që nuk ka plotësim të provave, por vetëm ka propozuar provat e vjetra që i ka harruar ti propozoj në aktakuzë.

Udhëheqja e procesit pa prova për lejimin e rregullave të ekstradimit, në kundërshtimin e aktakuzës e ka kundërshtuar se ky proces nuk mund të udhëhiqet sepse janë shkelur dispozita e ligjit për ekstradim. Prokurorja ne seancën e datës 01.03.2021 pas dëgjimit të dëshmitarëve, ka kuptuar se nuk ka propozuar asnjë provë, nuk ka propozuar ti lexoj disa dokumente të ekstradimit dhe gjykata në seancën e datës 01.04.2021 ka marr vendim për administrimin e provave dhe i ka pranuar, por çka me procedurën deri para asaj dite, mbi bazën e çkaje ai është sjellë, si ka mundur gjykata të procedojë, e është e tëra e jashtëligjshme.

Provat, në këtë proces është vetëm e dëmtuara D.1, e cila thotë se u dhunua nga Z.V. por askush nuk e vërteton tregimin e saj. Mund të kuptohet se dëshmitar të dhunimit nuk ka por nuk mund të kuptohet se si prokuroria nuk e ka siguruar asnjë dëshmi – provë, asnjë dëshmitar që dëshmon se e dëmtuara ishte në atë vend, në atë shtëpi të M. Xh. e prokurori pretendon se ishin mijëra njerëz që kanë pritur në atë vend të pajisen me dokumente identifikuese dhe e pabesueshme se si prokuroria nuk ka gjetur asnjë dëshmitar që e konfirmon prezencën e të dëmtuarës, kur vet e dëmtuara thotë se nuk ishte vetëm, sipas fjalëve të saj ishin, baba, nana, gjashtë motra, vëllai, vjehrra e asnjë prej këtyre personave ( natyrisht se sot nuk janë të gjithë të gjallë) prokuroria nuk i ka ftuar dëshmitar. Ajo ka përsëritur se në shtëpi ka hy me nënën, vjehrrën dhe motrën Sevdije dhe asnjë prej tyre nuk janë dëgjuar, gjatë gjykimit është kuptuar se vjehrra i ka vdekur, por nënën e ka të gjallë 70 vjeçare, jeton në Kosovë e do të dëgjohej pa vështirësi.

Për këtë rast çka flasin dy mjekët të cilët të dëmtuarës i ofruan ndihmën mjekësore, natyrisht të njëjtit nuk janë dëshmitar të ngjarjes dhe përveç gjendjes së pacientit nuk kanë çka të flasin. Doktor A.V. që i ka ofruar ndihmën ka treguar se nuk i ka bërë kontroll gjinekologjike por e ka ftuar doktoreshën e cila e ka kontrolluar dhe derisa doktoresha M. e ka kontrolluar nuk ka qene prezent është larguar. Dëshmitarja M. ka treguar se e ka thirr doktor V. se e ka një rast a po vjen grua është, e cila ka thënë se nuk është gjinekologe i ka kryer vetëm kontroll fizike me sy e ka



shiquar dhe është e qartë se ata nuk kishin përgatitje që është e nevojshme për kontroll gjinekologjike dhe është e qartë se ajo kontroll nuk ishte gjinekologjike. Andaj kemi një të dëmtuar e cila thotë se është dhunuar, por nuk ka asnjë provë, se e ka qenë në vendin kritik, kemi dëshmitar për gjendjen e saj të përgjithshme shëndetësore por asnjë për dhunim.

Identifikimi – njohja, sa i përket identifikimit të të akuzuarit dokumentacioni për këtë nuk ka asnjë kuptim. Nga data 10 mars 2016 kur Z.V. është arrestuar e deri sot shtypi kosovar dhe mediat në mënyrë të paligjshme ka shënuar për procedurat penale që udhëhiqen kundër tij dhe kanë publikuar fotografinë e tij të cilën e ka policia dhe prokuroria dhe ia kanë prezantuar dëshmitarëve për identifikim, lajmet me publikimin e fotografisë që shërben për identifikim, me artikullin me titull “Drejtësia e vonuar”, “pas 17 vitesh u arrestua kriminelë që ka vrarë civilët në Vushtri”, ose “kush është serbi i akuzuar për vrasjen e 116 shqiptarëve në Vushtri”. Është e qartë se nuk është e pamundur mos me e njoh dikën fotot e të cilit shtypi në Kosovë i ka publikuar çdo ditë, nga arrestimi i tij deri më sot dhe është e pamundur mos me njoh dikën që prej me herët e ke njohur. E dëmtuara nuk e njohu të akuzuarin por fotografinë të cilën e ka parë çdo ditë.

Për cilën grua kanë treguar dëshmitarët, bazuar në nenin 361 par.1 të KPPRK-së, gjykata aktgjykimin e saj e bazon vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor. Për arsye të kuptueshme, gjykata para fillimit të shqyrtimit ka marr vendim për fshehjen e identitetit të dëmtuarës-viktimës dhe i ka vënë pseudonimin D.1 dhe gjithashtu dëshmitarët të cilët janë dëgjuar në gjykatë, gjykata i ka udhëzuar që mos ta përmendin emrin e të dëmtuarës, çka edhe e kanë respektuar. Në dëshmitë e tyre dëshmitarët e kanë përmendur, “pacientja, një grua, gruaja, ajo”, doktoresha M. as nuk e ka njohur, nuk është pyetur për emër dhe nuk e dinë për kënd ka fol, njësoj edhe doktor Vojvoda i cili nuk e ka përmendur emrin e pacientes, të dëmtuarës dhe as pseudonimin e saj D.1, ashtu që nuk dihet për cilën grua ata kanë dëshmuar, të dëmtuarën D.1 apo për motrën e saj Sevdije, të cilën gjithashtu e kanë kontrolluar apo për ndonjë grua tjetër.

Mbrojtësi theksoj se, nga fillimi ka kërkuar që gjykimi duhet t’iu përgjigjet kërkesave të viktimave për një gjykim të drejtë, por gjithashtu të njëjtën të drejtë e ka edhe i pandehuri. Krimet e kryera kërkojnë drejtësi, e drejtësia nuk është udhëheqja e një gjykimi pa prova, shkelja e procedurës, e drejta në mbrojtje dhe një gjykim pa prova si dhe dhënia e shpresës së rrejtshme për kënaqësi të viktimave, aktakuza dhe thëniet e prokurorisë në shkresa të cilat nuk kanë asnjë bazë nuk janë prova, provat duhet të vërtetohen në shqyrtimin gjyqësor e në këtë rast nuk kemi asgjë, prokurori i shtetit nuk ka ofruar asgjë.

Aktgjykimin nuk duhet të merret në bazë të bindjeve dhe besimit personal, besimin është një gjë ndërsa faktet diçka tjetër, gjyqtarët duhet të udhëhiqen në bazë të fakteve, të vërtetës dhe provave. Në këtë rast i akuzuari Z.V. nuk ka arsye të brengoset, nuk ka kryer atë që i vihet në barrë dhe fundja nuk ka asnjë provë dhe me këtë bindje edhe presim vetëm aktgjykimin lirues.

I akuzuari Z.V. në fjalën e tij përfundimtare deklaroj se, e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësi të tij dhe shton se gjatë shqyrtimit gjyqësor të dëmtuarës i ka parashtruar vetëm një pyetje se, a ka bërë kontroll gjinekologjike tek mjeku i fushës përgjegjëse, e cila ka deklaruar po, ndërsa dy mjekët që kanë dëshmuar e kanë pohuar të kundërtën e këtij dikush nuk po e thotë të vërtetën, ndërsa sa u përket dëshmitarëve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar që të përjashtohen dëshmitë e tyre sepse ata nuk janë dëshmitar të dorës së parë, nuk janë ata që e kanë

parë ngjarjen, ata vetëm kanë treguar ngjarjet që i kanë dëgjuar prej të tjerëve e që edhe nuk janë kurrfarë dëshmitar e nuk ka as për çfarë ti komentoj dëshmitë e tyre, prova tjera nuk ka, është vetëm fjala e të dëmtuarës të cilës mundet shpirtërisht të thotë në sy se nuk e ka bërë atë veprë penale.

**Vlerësimi i dëshmive dhe analiza e tyre në raport me gjendjen faktike të vërtetuar-gjetjet e gjykatës:**

Pasi që gjykata bëri administrimin e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, të njëjta i vlerësoi dhe analizoi me kujdes e me ndërgjegje, secilën veç e veç dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, se i akuzuari Z.V. ka kryer veprën penale, Krimet e luftës kundër popullsisë civile, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Gjykata, gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga administrimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor, si atyre personale, dëshmisë së dëshmitarëve, si në vijim: nga dëshmitarja D.1; A. V.; M. I.; Sh. G.; M. Xh.; S. I.-C. dhe V. D.-Xh. kurse është lexuar dhe administruar edhe dëshmia e dëshmitares D. B.

Në arsyetimin e mëtejshëm të këtij aktgjykimi do të bëhet analizë e provave të lartë-theksuara, respektivisht analizë e tyre si prova të veçanta dhe të ndërlidhura ndërmjet vete, duke i elaboruar arsyet për të cilat gjykata ka marrë këtë aktgjykim.

Gjykata si fakte të pa-mohueshme në këtë çështje penale (gjatë shqyrtimeve gjyqësore) në raport me këtë të akuzuar ka vërtetuar se:

Vepra penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit Z.V. Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, është kryer me datë 22 maj të vitit 1999 në Qytetin e Vushtrrisë.

Është fakt i pakontestueshëm se në atë kohë (kohën e kryerjes së veprës penale), ishte shpallur zyrtarisht gjendja e luftës, ku me datë 24 mars të vitit 1999 kishte filluar Operacioni Ushtarak i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, me qëllim të ndalimit të abuzimeve të të drejtave të njeriut në Kosovë, ku me atë datë Republika Federative e Jugosllavisë shpalli zyrtarisht gjendjen e luftës e cila shtrihej në tërë territorin e Kosovës.

I akuzuari Z.V. akuzohet se veprën penale e ka kryer si pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e që këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, si nga dëshmia e dëshmitarës D.1, po ashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve A. V. dhe M. Xh. si dhe është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.54/17, të datës 25 maj të vitit 2018.

Dëshmitarja D.1, në dëshminë e saj të dhënë si në polici, prokurori dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se me datë 22 maj të vitit 1999 afër varrezave të Vushtrrisë në shtëpinë dy katëshe, ku kati i parë ishte krejt me xhama, duke pritur në kolonë për tu pajisur për kartelë identifikimi e ka parë të akuzuarin në uniformë policore ku i kishte shkruajtur policija në çirilicë, i cili ishte me uniformë me ngjyrë të kaltër në të hiri si dhe i armatosur – allti në shok dhe shkop të gjatë dhe për herë të parë, nga njerëzit që i kishte afër kishte dëgjuar duke folur se “jemi shumë në rrezik, sepse brenda është Z.V.”, ku prej tyre edhe mësoj emrin e tij, ngase deri atë ditë nuk e kishte njohur kush është, por me të mësuar emrin e tij dhe kur e kishte parë për herë të parë me datën 22 maj, e kujtoj se atë person e kishte parë në uniformë policore edhe me datën 02 maj 1999 derisa ishte në kolonë në fshatin S... i cili person kishte rrahur shumë njerëz si dhe në Kooperativën Bujqësore në Vushtri.

Faktin se i akuzuari, Z.V. ishte polic – pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë, e vërtetoj edhe dëshmitari M. Xh. i cili në dëshmitë e tij të dhënë në fazën e hetimeve edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se meqë është banor i Vushtrrisë, të akuzuarin e ka njohur mirë, ngase i akuzuari kishte punuar në shkrimoren e gjykatës Komunale në Vushtri, i cili ishte një djalë i gjatë i cili gjatë kohës së luftës ishte i veshur me rroba të policisë.

Të veshur me uniformë policore, dëshmitari Xh. e kishte parë të akuzuarin Z.V. në fillim të muajit maj të vitit 1999 herët në mëngjes, rreth orës 07:00 - 07:30, kur i akuzuari së bashku edhe me një polic tjetër kishin ndaluar me një veturë para dyerve të shtëpisë së axhës së tij Rr. Xh. dhe kishin hyrë brenda në shtëpinë e axhës, ku të akuzuarin Z.V. e kishte njohur pasi që ishte pa maskë dhe me automat në dorë, ndërsa policin tjetër jo, dhe ishte në distancë me ta 22-25 metra, por Z.V. të veshur me uniformë policore dhe të armatosur e kishte parë edhe me datën 22 maj të vitit 1999 tek varrezat e qytetit të Vushtrrisë.

Faktin se i akuzuari Z.V. ishte pjesëtar i forcave policore të njësisë rezervë të MUP-it të Serbisë është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.54/2017 i datës 25 qershor 2018 ku është vërtetuar se në mes të 3 maj 1999 dhe fillimit të qershorit 1999 kishte cilësinë e policit rezerve të Stacionit Policor në Vushtri, andaj mbi bazën e këtyre dëshmime padiskutueshëm u vërtetua se i akuzuari ishte pjesëtar i forcave serbe.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëshmitë e dëshmitarëve, u vërtetua se gjatë muajit maj të vitit 1999 në Vushtri kishin ndodhur sulme të gjëra dhe sistematike nga forcat ushtarake, paramilitare policore kundër popullsisë civile shqiptare, dëbimi i popullsisë nga vendbanimet e tyre, dhunë fizike, psikike, maltretime, veprime qnjerezore si dhe dhunime seksuale të femrave shqiptare.

Këtë fakt e vërtetoj me dëshminë e saj dëshmitarja e dëmtuara D.1 e cila dëshmoj se kishte jetuar në shtëpinë e saj në fshatin ... Komuna e Vushtrrisë deri më datën 29 janar të vitit 1999 kur së bashku me familjën e saj ishin detyruar që për shkaqe të sigurisë ta lëshonin shtëpinë e tyre për të gjetur strehim nëpër fshatrat e Vushtrrisë ku edhe disa herë kishin ndërruar vendqëndrimet e tyre duke jetuar në shtëpi të huaja, shtëpi të granatuara si dhe nëpër male për ditë të tëra.

Kishin qëndruar në fshatin ... Komuna Vushtri deri më datën 25 mars të vitit 1999 kur forcat të shumta ushtarake policore me tenka dhe me mjete tjera kishin hyrë nëpër shtëpia dhe i kishin larguar duke i futur në kolonë për ti dërguar në kazemën e ushtrisë në Vushtri, ku në atë kolonë

kishte numër shumë të madh të popullsisë ku i kishin lënë të qëndrojnë ashtu duke u thënë se do ti fusin në kazermë dhe do ti bombardon Natoja e të gjithë do të vdesin aty, por nuk i kishin futur, pasi që një ushtar me një telefонтë që kishte marrë ju kishte bërëtitur në gjuhen serbe që të shkojnë kah të dojnë, por me sytë e saj e kishte parë një person civil të cilin e vranë derisa ikte në drejtim të arave, pasi që nuk kishte pranuar të futet në atë kolonë.

Pas disa ditë qëndrimi në një shtëpi së bashku edhe me prindërit e saj, 6 motrat dhe vëllaun 9 vjeçar, vjehrrën dhe dy vajzat e vogla, kishin dëgjuar se me autobus po i largojnë popullsinë jashtë Kosovës dhe tek varrezat e Vushtrrisë kishin hy në autobus për të shkuar në drejtim të Prishtinës, por me të arritur në fshatin ... Komuna Vushtrri kanë dal nga autobusi, pasi që nuk dinte asgjë për burrin e saj dhe nuk u larguan nga Vushtria, vetëm kërkuan një shtëpi për tu strehuar.

Nëpër shtëpi dhe nëpër male qëndruan tri javë deri më datën 2 maj të vitit 1999, kur ishin detyruar që të largohen nga fshati C. ku qëndruan së fundi, ngase këmbësoria serbe i ishte afruar fshatit dhe i gjithë fshati C. kishin dal dhe kanë hyrë në kolonë, ku janë nisur në drejtim të Vushtrrisë, duke kaluar nëpër fshatin S... kur aty u ishte bashkuar edhe burri i saj dhe ishte me vjehrrën dhe vajzat e vogla, njëra 3 vjeçe e tjetra 9 mujshe.

D.1, dëshmoj se kishin ndaluar një traktor dhe sapo kishin filluar që të lëvizin, policia i kishte ndaluar, u kishin marrë krejt çka kishin me vete, ari, pare, krejt çka kishin ua kishin dhënë, të cilët tytat e armëve i kishin të mbajtura në drejtim të tyre dhe para syve të tyre kishin vrarë vozitësin e traktorit, kurse e kanë detyruar për shkak mos të bohet kolonë një djalë 12 vjeçar që ta vozis traktorin, të cilin e kanë goditur dhe rrahur shumë që ska ditur ta vozis traktorin dhe D.1 së bashku me vjehrrën dhe vajzat kishte kërcyer nga traktori.

Këto veprime të tmerrshme nga forcat policore dhe ushtarake serbe, ndodhën para syve të dëmtuarës D.1 e cila gjatë asaj rruge pa njerëz të vrarë në rrugë, vajza e saj kishte shkelur mbi kufoma, pa njerëz të rrahur dhe sipas urdhërave të forcave policore ishin detyruar që të shkojnë në drejtim të Koopertivës Bujqësore në Vushtrri krejt kolona ku kishte parë që i ndanin meshkujt dhe të rinjt nga kolona të cilët nuk dihej se kah i kanë dërguar.

Së bashku me popullatën një natë kishin qëndruar në Kooperativen Bujqësore dhe pasi që i liruan në mëngjes përsëri ishte kthyer në shtëpinë ku kishte qëndruar edhe më parë tek varrezat ku kishte edhe familjën e saj, prindërit, motrat dhe vëllau dhe qëndruan deri më 22 maj 1999, kur në orët e hershme të mëngjesit policia dhe ushtria serbe, thyen dyert e oborrit dhe i qitën jashtë duke i sharë dhe rrahur ku nuk u dhanë shumë kohe dhe duke iu bërëtitur i drejtuan tek varrezat, ku kishte shumë njerëz të cilët me dhunë u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Kishte shume ushtri, shume polic dhe paramilitar, e kishte parë edhe të shtrirë në tokë dhe me shpata duke i ngulur për toke, ndërsa të gjithë djemt e ri i pa që i kishin ndarë dhe të mbështetur për muri, kurse gratë, fëmijët dhe pleq i kanë rreshtuar në kolonë në drejtim të një lokali-shtëpie me xhama dy katëshe, për të pritur se në atë shtëpi do të regjistroheshin.

Në atë kolonë duke pritur ishte së bashku me vjehrrën, vajzat e vogla dhe me familjën e saj, por ngaqë ishte kolona e gjatë nuk i kishte të gjithë afër, afër kishte një motër, dy vajzat e saj dhe

vjehrrën dhe pritnin për tu pajisur me kartona, ku edhe kishte parë njerëz që dilnin prej aty me kartona, por vet asnjëherë nuk u regjistrua dhe nuk e morri atë karton.

D.1, derisa po priste në atë kolon, ishte ishte hera e parë që nga njerëzit në kolon përmendën emrin e të akuzuarit Z.V. dhe se aty janë në rrezik se ai ishte brenda, por kur e pa vet ai person iu kujtua se e kishte parë edhe në kolonë në fshatin S... dhe natën që qëndruan në Kooperativën Bujqësore, në të të gjitha rastet ai ishte në uniformë policore, ishte agresiv, me datën 2 maj, kishte shumë persona në S..., ndërsa i akuzuari “ka rrah njerëz sa ka mujt”, ndërsa në Kooperativë bujqësore asaj (D.1), nuk i ka ndodhur asgjë, por forcat serbe kishin marrë gra e femra të reja e pastaj i kanë kthyer në mesin e famijlarëve të cilat kur ishin kthyer qanin, ishin të trishtuara, të gërvishura me rroba të qkyera.

Sa i përket, sulmeve të gjera e sistematike, dëbimeve të popullsisë civile shqiptare, nga shtëpitë e tyre dhe malterimet e bëra ndaj tyre, e vërtetoj me dëshminë e tij dëshmitari, A. V. i cili së bashku me familjën e tij ishte në mesin e qytetarëve të dëbuar nga shtëpia e tij me datën 22 maj të vitit 1999, në orët e hershme të mëngjesit nga forcat paramilitare serbe dhe pjestëtarë të policisë dhe u tubuan qytetarë të shumtë rreth 20.000 -30.000 veta, që nga mëngjesi i hershëm e deri në mbrëmje në orët e vona dhe ishin të rrethuar dhe në gjendje shumë të rëndë.

Njesoj dëshmoj edhe dëshmitarja M. I. e cila ishte së bashku me familjën e saj që u detyruan ta lëshonin shtëpinë e tyre në fshatin P..., ku kishin qëndruar një kohë në fshatin V..., e ku edhe prej aty u detyruan që të largohen për shkak të rrezikut, ku për një kohë qëndruan në Vushtrri te A.J., nip i burrit të saj, por u larguan edhe prej aty kur filluan bombardimet dhe së fundi kishin qëndruar te shtëpia e A. V.

Derisa kishin qëndruar në shtëpinë e A. V., disa herë i kishin kontrolluar forcat serbe, ndërsa me datën 22 maj të 1999, policia dhe ushtria i kanë larguar nga shtëpia dhe i kanë drejtuar tek varrezat e qytetit, ku aty ishte tmerri, i ndanë burrat nga gratë, kanë rrah burrat sa kanë mundur saqë u kishte lakmuar të vdekurve, kishte shumë frikë ngase meshkujt i kanë ndarë nga femrat dhe kamionat i kanë mbushur me të rinj, ku në mesin e tyre ishte edhe kunati i saj R. me profesion mjek si dhe një koleg dr. R. K., dhe se tërë atë ditë qëndruan tek varrezat, ndërsa në mbrëmje i liruan dhe u kthyen përësi në shtëpinë e A.

Po ashtu, kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe me dëshminë e dëshmitarit, M. Xh., i cili deklaroj se gjatë muajit maj të vitit 1999 herët në mëngjes, rreth orës 07:00 - 07:30, e kishte parë të akuzuarin së bashku edhe me një polic që kishin hyrë në shtëpinë e axhës së tij Rr. Xh., prej të cilit edhe ishte fshehur papa muri, e kur e kishte vërejtur i akuzuari i ishte vënë pas duke e ndjekur dhe i duke i bërëtitur në gjuhën serbe me fjalët “stani” (ndalu), por dëshmitari kishte vrapuar duke ikur prej tij dhe kishte kaluar në mes të dy shtëpive ku kishte shkuar te fqinji i tij Xh. dhe akoma e dëgjonte të akuzuarin duke bërëtitur “gde je otisao” (ku shkoj).

Më tej, dëshmoj se kishte arritur që të largohej pak prej aty duke mos i rënë në sy të akuzuarit, dhe se nuk ishte larg tij, por i fshehur dhe prej asaj pozite nuk ka mundur të shohë por me veshët e tij kishte dëgjuar të akuzuarin Z. kur u kishte marr të holla qytetarëve, nga A. kishte marrë 360 DM, e që ato që i kishte dëgjuar edhe ia kishte konfirmuar vet A.

Dëshmitari dëshmoj se ka jetuar në shtëpinë e tij në Vushtrri dhe se në mëngjesin e herëshëm të datës 22 maj të vitit 1999, ushtria dhe policia serbe i larguan nga shtëpia të gjithë banorët dhe të gjithë i dërguan përtej varrezave ku grumbulluan gjithë popullatën të varrezat në Vushtrri në anën e djathtë që ishte një fushë e pa punuar prej disa hektarëve dhe kishte mija njerëz të të gjitha moshave dhe fillimisht pa vetëm polic, por asnjë prej tyre nuk i njohu, të cilët nga qytetarët u merrnin telefonat, kurse të gjithë popullatën, fëmijë, femra, meshkuj, i kishin ulur në tokë dhe pas gjysme ore, e kishte parë Z.V. me një shtag – krryle, e cila ishte e punuar e jo e blerë, i cili filloj ti rrah të gjithë me rend të cilët ishin të ulur, gra fëmijë pa mos dalluar asnjë duke i goditur pandërprerë, kurse vet nuk kishte marrë asnjë goditje ngase ishte larg prej tij diku rreth 10 metra dhe aty e kishte parë edhe zëvendës komandantin me mbiemër T. që i bërtet të akuzuarit Z. në gjuhën serbe “pse po i rrah njerëzit e pafajshëm”, ku Z. ia kthen “krejt kom me i mbyt” ku personi T. ia kishte marr shtagën nga dora dhe e kishte thyer në gjurin e tij dhe i kishte përsëritur edhe një herë fjalët, mos i rrah njerëzit e pafajshëm.

Deklaroj, se derisa ishte aty kishin filluar ti ndanin meshkujt dhe ti hipnin në kamione, por meqë ishte pak më larg edhe kishte shpetuar, kurse Z. e kishte përcjell, për faktin se Z. i ka njohur dhe ia kishin frikën, i cili pas gjysmë ore nuk ishte më aty dhe e pa që ishte nisur në drejtim të shtëpisë së tij ( të dëshmitarit), aty ku ishte bërë grumbulli i njerëzve, të cilët ishin rreshtuar se bënë evidencën e popullatës dhe njerëzit hynin në shtëpi dhe kanë dal, por nga turma e madhe e njerëzve nuk mundi ta veçonte dikend se kush ishin, pa se kishte gra fëmijë, djem, i cili tubim kishte zgjatur deri kah ora 13:00 - 14:00, kur pas asaj kohe pa se shtëpisë së tij dhe shtëpisë ku hynin njerëzit i doli tymi dhe nga zjarri ska munduar të hyj por ka shikuar nga afërsia.

U vërtetua se ajo shtëpi ku pritnin në rresht-radhë për tu pajisur me kartela të identifikimit ishte shtëpia e doktor R. Xh. vëllaut të dëshmitarit M. Xh. kurse dëshmitari nga njerëzit kishte dëgjuar se brenda në shtëpitë e tyre u dhunuan njerëz, u rrahën dhe kanë plaçkitur krejt çka kishin.

Gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitares D. B. e cila në dëshminë e saj të dhënë në polici ka deklaruar, se ka jetuar së bashku me familjën e saj në fshatin D..., por pas vitit të ri 1999 ishin detyruar të largohen nga shtëpia ngase ishin larguar të gjithë banorët e fshatit, se kishin dëgjuar se serbët do ti rrethonin, ku në fshat jetonin edhe banor të nacionalitetit serb.

Pas daljes nga shtëpia kishin shkuar te vajza e tyre dëshmitarja D.1 ku kishin qëndruar një javë e më pas kishin shkuar në fshatin N... e B..., pasi që kishin hy forcat serbe dhe i kanë detyruar që të largohen e që posa janë larguar u kanë vënë flakën shtëpive. Pas largimit nga fshati N... ishin në kolone dhe kishte parë ushtar me uniform të gjelbër me lara dhe armë të gjata automatike, polic me uniform ngjyrë tjetër e atyre që ju thoshin paramilitar në kokë me shamia të lidhura, me ftyra të ngjyrosura e në duar e xhepa thika të gjata, ku i kishin përcjell deri në kazermen e ushtrisë në Vushtrri dhe deri në terr i kishin mbajur, e pastaj i kishin liruar.

Tha që bashku me familjën e saj, qëndruan nëpër shtëpia tu huaja dhe një ditë u nisën me autobus së bashku me familjën duke menduar se po largohen nga Kosova, por në fshatin P..., kishin zbritur së bashku me familje dhe me të ishte edhe vajza D.1 dhe më pas u strehuan në Vushtrri tek një kushëri i burrit të vajzës së saj dhe në shtëpinë e një personi me emrin M. në të cilën shtëpi kishte parë gjurmë të gjakut ku në atë shtëpi qëndruan deri në përfundimin e luftës.

Dëshmitarja, deklaroj se me datën 22 maj forcat serbe i dëbuan nga shtëpia ku ishin duke qëndruar së bashku edhe vajzën e saj D.1 e cila ishte me vjehrrën dhe me dy vajzat, kur dëgjuan krisma të forta të dyerve të dhomave dhe kishin hyrë shumë ushtarë dhe serb të uniformuar të armatosur që në gjuhën serbe duke i sharë e duke i goditur me shqelma i detyruan që të dalin në oborr dhe nën përcjelljen e tyre i dërguan në fushën afër varrezave në Vushtrri, ku kishte shumë njerëz që i kishin tubuar dhe i mbajtën të ulur për disa orë derisa grumbulluan gjithë popullatën.

Tha se kishte parë atë ditë që ndanin burrat dhe të rinjte nga gratë, që i mbanin në këmbë me duar mbrapa kokës të mbështetur me fytyra për muri, ndërsa nën përcjelljen e forcave serbe i detyruan që të ecin deri afër një shtëpie që ishte afër varrezave dhe u flisnin në gjuhën serbe, që nuk e kuptonte, por burri i kishte treguar se policët u kishin thënë duhet me prit mu regjistru dhe do tju jepin kartela me ditë sa persona ku po banojnë dhe deri sa ishin duke pritur para asaj shtëpie dykatëshe, kati i parë ishte krejt me xhama, kishte parë shume polic, ushtar e paramilitar të armatosur që ishin brenda dhe në të dyja anët e lokalit ishin nga dy persona te uniformuar e të armatosur e që kur u vinte radha me hy brenda ata i goditnin me shkop druri dhe i kanë shtyrë brenda në lokal, ndërsa ishte në radhë duke pritur me 7 vajzat e saj dhe me djalin e vogël, vjehrra e D.1, ndërsa burrin nuk ishte afër saj, nuk ishte brenda ngase kishte mbetur diku në kolonë.

Gjykata po ashtu e vërtetoi, se me datë 22 maj të viti 1999, i akuzuari, Z.V. i uniformuar - polic i njësisë rezerve, në Stacionin policor në Vushtrri dhe i armatosur, në shtëpinë e R. Xh. kreu aktin e dhunimit seksual ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar, ndaj D.1. e këtë fakt e vërtetoi nga dëshmia e të dëmtuarës-dëshmitare D.1 e cila në mënyrë të qartë dhe bindëse ka dëshmuar se derisa ishte duke pritur në radhë për tu regjistruar dhe pajisur me kartele aty ku i detyruan forcat serbe para një shtëpie dy katëshe, e mësoj emrin e të akuzuarit prej njerëzve që pritnin aty e të cilët edhe e kishin njohur dhe kishin thënë se është i rrezikshm, e njëjta dëshmoj se ishte e frikësuar ngase tërë kohën e kishte shikuar, sipas dëshmitarës “kurr syt smi ka da” që tek e njëjta ishte krijuar një ndenj e çuditshme dhe kishte frikë e cila ishte së bashku me motrën, nënën, vjehrrën dhe dy vajzat e saj, njëra 9 mujashe që e mbante në krah dhe vajza tjetër 3 vjeqe.

I akuzuari me t’iu afruar D.1, e kishte tërhequr për krahu, vajzën që e mbante në krah ia kishte përplasur për toke ku kishte reaguar vjehrra e saj që e kishte afër dhe i kishte kërkuar të akuzuarit që ta merrnin atë dhe ishte gërrbav me e marr vajzën në tokë, ku i akuzuari me kondak të automatit e kishte goditur në kokë, respektivisht në balle duke e gjakosur, por i akuzuari e kishte tërhequr D.1 me ndihmën e një polici tjetër dhe e kanë dërguar në katin e dytë, në një dhomë ku kishte edhe femra tjera shqiptare të zhveshura që dhunoheshin nga serbet në mënyrën më brutale.

D.1, dëshmoj se ishte i akuzuari i cili i kishte kërkuar në gjuhën serbe që të zhvishet, por e njëjta duke u bërë kinse nuk e kuptonte nuk i kishte dëgjuar urdhrat e tij për tu zhveshur dhe i akuzuari me force i kishte shqyer rrobat në pjesën e sipërme dhe e kishte zhveshur në pjesën e poshtme, duke ia larguar trenerkat dhe brekët dhe e kishte përplasur në dysheme, ku kishte filluar akti i dhunimit, ku shoku i tij i fliste në gjuhën serbe dhe disa herë e kishte thirrë në emër “Z., Z.” dhe derisa i akuzuari Z. kryente aktin e dhunimit vaginal, polici tjetër ia mbyllte gojen, e puthte në gojë dhe i shtërngonte gjokset.

D.1 në atë kohë ishte shtatëzënë në muajin e tretë me dy foshnje binjake dhe meqë kishte të vjella ishte thyer anash për të vjellur dhe duke menduar se po vllte për shkak tyre, të cilëve sipas dëshmitarës u vinte erë e rëndë, i akuzuari e kishte goditur fort me shkëlqim në kurriz e cila nga dhimbja e fortë kishte humbur vetëdijën dhe më nuk kishte ndier asgjë, vetëm kur i ishte kthyer vetëdija e ka parë vetën krejtësisht të lagur të zhveshur të cilës i vinte erë e rëndë e që nuk e dinte se çfarë ishte, urinë apo çfarë dhe një polic e kishte kapur për krahu dhe me një shleqm e kishte larguar prej aty duke i bërtitur në gjuhën serbe bezi, “ik” dhe prej aty kishte shkuar te shtëpia ku kishin qëndruar së fundi ku takoi nënën dhe familjën e saj.

D.1, bëri përshkrimin e të akuzuarin Z.V., një person i gjatë, me flokë ngjyrë kafe, i pashëm, i moshës 25-30 vjeçar, të njëjtin e identifikoj edhe në bazë të fotografisë së asaj kohe, si dhe në momentin kur i akuzuari hyri në sallën e gjyqimit, dëshmitarja tha se pësoj një dridhje të madhe dhe ishte shumë e shqetësuar pasi që kujtoj ato momente, të cilat për të ishin të paharruara dhe përkundër faktit se ka kaluar shumë kohë prej atëherë, ku i akuzuari edhe kishte ndryshuar për të mbeti i njëjti dhe menjëherë e njohu.

D.1, si pasojë e dhunës seksuale të datës 22 maj, të shkaktuar nga i akuzuari dhe kolegu i tij, në orët e vona të mbrëmjes vjehrra dhe motra e saj e kishin dërguar tek një mjek i përgjithshëm A. V. i cili jetonte afër varrezave në Vushtrri, i cili e kishte kontrolluar në shtëpinë e tij ku një dhomë e kishte ordinancë dhe i kishte ofruar ndihmën mjekësore, ku e dëmtuara kishte gjakderdhje dhe mjeku e kishte thirrë një grua doktoreshë që ta kontrollonte.

Dëshmoj se ka pasur vetëm kontrollë të përgjithshme nga ana e dy mjekëve por prej tyre nuk është udhëzuar për kontroll gjinekologjike dhe as nuk kishte bërë kontroll gjinekologjike. Është trajtuar me antibiotik dhe mjeku e kishte trajtuar për pesë ditë me radhe dhe me mjekun kishin biseduar së bashku ku i kishte treguar se çfarë i kishte ndodhur atë natë dhe kush ia kishte shkaktuar dhunimin, se këtë ia bëri Z.V. të cilin e kishte njohur edhe mjeku.

D.1, ka dëshmuar se atë ditë me të duke pritur në radhë ishin edhe nëna dhe vjehrra e saj të cilat e kishin parë kur të njëjtën me forcë e kishte tërhequr i akuzuari dhe ia kishte përplasur fëmijën për toke, por vjehrra e saj tani më nuk jeton dhe për këtë rast nuk ka dhënë dëshmi asnjëherë, ndërsa nëna e saj D. B., e cila është gjallë ka dhënë dëshminë e saj në polici dhe të njëjtën gjykata e lexuar dhe e ka administruar si provë.

Fakti se e dëmtuara D.1 ishte dhunuar atë natë, vërtetohet në tërësi edhe me dëshminë e dëshmitarës D. B. respektivisht nënës së saj, e cila ka treguar se së bashku me vajzat e saj ku ishte edhe D.1 derisa pritin në rradhë për tu regjistruar, kur u kishte ardhur radha D.1, me forcë e kishin tërhequr duke ia përplasuar vajzën e vogël nga krahu për toke dhe e kanë tërhequr duke e dërguar lart në katin e dytë prej nga edhe ia kishte dëgjuar piskamën, por nuk e dinte se kush ishte ai person që e kishte marr, nuk i kujtohej dhe nuk e kishte shikuar fare, ngase kishte frikë të madhe për vajzat e saj të reja që i kishte aty me vete. Ajo dëshmoj se nuk e kishte njohur të akuzuarin Z. as nuk e dinte kush ishte ai, kush u'a bërë atë dhunë vajzës së saj, nuk bëri përshkrim fare dhe asnjëherë nuk përmendi emra të askujt, përveç faktit se ia morren vajzën para syve të saj, nuk kishte si ti ndihmonte, nuk mundi ta ndal, kurse vet ishte regjistruar dhe e kishte marrë atë karton dhe derisa po dilte prej asaj shtëpie me forcë ia morren edhe vajzën tjetër S. e cila në atë kohë ishte vetëm 19 vjeçare të cilën e kishin ndalë në të njëjtën shtëpi, nuk e dinte se kush ia morri, i luti që t'ia lirojnë



vajzën duke i ofruar edhe para por nuk ia liruan dhe nuk mundi as ti ndaloj e as ti mbrojë vajzat e saj dhe kur kishte dalë prej aty, kurse në rrugë kishte parë kamionet e serbëve duke i ngarkuar burrat në të dhe të nisur në drejtim të qytetit të Vushtrrisë.

Dëshmitarja, tha se ma vonë, atë ditë kur kishte rënë terri, në shtëpi ishte kthyer D.1 të cilën kur e kishte parë ka bërë titur ngase ishte në gjendje shumë të rëndë, me rroba të shqyera, me floke të shkulura, fytyra dhe qafa e saj krejt e mavijosur dhe me shenja të kafshimit të dhëmbëve, e skuqur e grithur, në qafë, gjoksa në pjesën e poshtme tek pantallonat i rridhte gjaku, të cilës kohe pask kohe i humbte edhe vetëdija dhe atë natë e kishin dërguar tek mjeku A.V. i cili i kishte ofruar ndihmë vajzës së saj e cila në atë kohë ishte shtatzënë në muajin e tretë.

Meqë vajza e saj, tjetra të cilën ia morrën policia në të njëjtën shtëpi nuk ishte kthyer gjithë natën, dëshmitarja tha se të nesërmen kishte dal vetë për ta kërkuar dhe kishte shkuar duke hyrë nëpër shtëpia ku ishin dyert e hapura dhe në një shtëpi ku dera ishte e gjysëm e hapur kishte parë tmerr me sy, gjymtyrë të trupave të masakruar, gishtërinj, vesh, duar, këmbë, koka, sy të nxjerrur, kurse prej një personi i cili po e kërkonte edhe ai vëllaun e tij kishte mësuar se ajo ishte shtëpia e K. P.

Pasi ishte kthyer në shtëpi, ishte kthyer vajza tjetër e cila mezi ecte, e humbur krejt, thaj krejtësisht e zhveshur, me rroba të shqyera, trupi i saj fytyra krejt të majivisura, shenja të kafshimit nga dhëmbët dhe duke bërë titur tërë kohen nuk i kishte lënë as ta prekin, dukej krejtësisht si e çmendur, të cilës ndihmën mjekësore ia kishte ofruar mjeku A. V. i cili kishte shkuar në shtëpinë e tyre, ngase ishte e pamundur që vajzën ta nxirrin nga shtëpia në gjendjen që ishte.

Dëshmitarja vërtetohet se kishte përjetuar tmerrin, dy vajzat ia dhunuan, kishte parë se serbët kishin marrë edhe femra të tjera por nuk i ka njohur dhe nuk e din kush janë. Vajza D.1, e cila në kohën e dhunimit ishte shtatzëne, pas luftes kishte abortuar dhe humbi binjakët.

Gjendja faktike e dhunimit të D.1, u vërtetua pa kontestueshëm edhe me dëshminë e dëshmitarit, A. V. mjek nga Vushtrria, i cili në rrethana të luftës u kishte ofruar ndihmë popullsisë aq sa kishte pasur mundësi, kurse shënime për trajtimin e pacientëve nuk kishte mbajtur për shkak të gjendjes së luftës.

Dëshmitari, A. V. me profesion mjek i përgjithsëhm ka deklaruar se me datën 22 maj 1999 pasi që forcat serbe i kishin lënë të lirë në orët e mbrëmjes ishin kthyer në shtëpinë e tij dhe e kanë thirrë se është një rast dhe kishte shkuar për ta kontrolluar, por me të parë pacientin që nuk e kishte njohur, e njëjta kishte qenë në gjendje jashtëzakonisht të rëndë, e dëmtuar ku i kishte bërë kontrollin fizik të trupit të saj dhe kishte parë gjakosje në organin gjenital, në pjesët e sipërme gërvishje dhe në gjendje alarmuese për të, e trishtuar, me hematome duke filluar nga gjinjët e teposhtë trupit dhe për shkak se ishte femër e ka thirrë edhe dokoreshën M. e cila punonte dhe njëkohësisht banonte në shtëpinë e tij.

Pacientja ishte shpirtërisht e lodhur ka përmendur emrin e Z. V. të cilin dëshmitari e kishte njohur ngase është nga Vushtrria, por aty i kishte interesuar vetëm ana mjekësore e pacientes, por meqë i kishte ardhur keq për ta kontrolluar në organet gjenitale, dokoresha e ka bërë kontrollin e saj në organet gjenitale dhe në trup në pjesën e sipërme dhe në konsultim me dokoreshën i kanë pastruar pjestë e trupit ku kanë mundur, i kanë dhënë qetësues kundër dhimbjes dhe terapi me analgetik.

Tha se nuk i kanë kryer kontroll gjinekologjike, por vetëm kontroll të përgjithshme. Këtë rast e mbante në mend, ngase ishte rasti më i rëndë që e kishte pasur e që i ka mundur të gjitha rastet e tjera, ngase tjerat ishin të natyrës së lehtë krahasuar me këtë rast.

Gjendjen faktike të dhunës së pësuar të D.1 e vërtetoj edhe dëshmitarja M. I. e cila dëshmoj se është me profesion specialiste e mjekësisë familjare dhe këtë profesion e kishte ushtruar edhe gjatë kohës së luftës dhe se natën e datës 22 maj 1999, pasi që ishin kthyer në shtëpi ku paraprakisht ishin dëbuar nga shtëpia në mbrëmje kishin pasur disa raste, por një rast më i veçantë ishte kur e kishte thirrë doktor A. që ta kontrolloj një femër të cilës i kishte bërë kontrollin fizik, ajo nuk ishte gjinekologe, por me rastin e kontrollit fizik të trupit të dëmtuarës ka parë hematome me gervishje, shqyerje dhe ishte koncentrua në pjesën e poshtme të trupit. Organet gjenitale vetëm me sy i ka parë kishte disa shqyerje, hematome dhe në pajtim me mjekun A. i kanë përshkruar terapine dhe mbante në mend se e kishte pyetur se kush ta bëri, ku D.1 i kishte thënë Z. por dëshmitarja Z. nuk e njihte kush është.

Se e dëmtuara D.1, si pasojë e dhunimit të shkaktuar ndaj saj, kishte pësuar lëndime fizike dhe psikike, këtë e vërtetoj me dëshminë e tij edhe dëshmitari Sh. G. i cili ishte me profesion mjek, i cili e kishte trajtuar të dëmtuarën D.1 në periudhën e pas luftës, respektivisht në vitin 2013, ku edhe në atë periudhë kohore të njejtën e ka trajtuar me sedativ për shkak të gjndjës së rëndë emocionale, ku e dëmtuara i kishte përmendur se ishte i akuzuari Z.V. i cili e kishte dhunuar. Ky dëshmitar kishte trajtuar gjatë periudhës së luftës 2-3 raste të dhunë seksuale të kryera nga forcat serbe, por të dëmtuarën e kishte trajtuar pas lufte, në vitin 2013.

Po ashtu ky dëshmitar, ka deklaruar se kishte njohur dy nga dëshmitarët okular, që të dy tani të ndjerë, të cilët i kishin rrëfyer se vajzat e tyre, njëra 18 dhe tjetra 16 (tani e ndjerë) kishin qenë viktimë e dhunimit seksual nga i akuzuari Z.V.

Edhe dëshmitarja V. D. –Xh. mjeke në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës (QKRMT), ka dëshmuar se D.1 e kishte takuar për herë të parë në vitin 2017, në një gjendje stresuese dhe nga ajo kohë i është hapur kartela në QKRMT, ku e njëjta ishte rrëfyer për dhunën seksuale të përjetuar, çdo herë kishte përmendur emrin e dhunuesit Z.V. dhe është ankuar nga dhimbjet e mëdha në boshtin kurrizor nga goditja që kishte marrë gjatë dhunimit seksual, ku në atë kohë ishte shtatëzënë në muajin e tretë kurse më vonë kishte pasur abort.

Edhe nga dëshmitarja S. I.- Q. psikologe në QKRMT, u vërtetua se e dëmtuara D.1, kishte pësuar çrregullim të stresit postraumatik e që simptomat e stresit postraumaik menjëherë pas ngjarjes ishin të nivelit më të lartë të mundshëm, ndërsa me kalimin e kohës me mbështetjen e familjes këto simptoma kanë pësuar ulje nga shifra 4 që është më e lartë në 2 që është gjendja e saj aktuale, e cila edhe përkundër trajtimit të vazhdueshëm ende nuk e ka kaluar çrregullimin e stresit postraumatik edhe pse ka rënie të dukshme të simptomave, ende i ka prezente dhe vlerësimi i ekspertës është se trauma e përjetuar ka ndikuar dhe vazhdon të ndikoj në mirëqenien e saj fizike dhe psikike dhe në funksionimin e saj personal dhe social, dhe se në praktikën psikologjike, dhunimi konsiderohet si ndër përvojat më të rënda që mund ti ekspozohet një person.

Rrjedhimisht, gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, se kishte ndodhur një sulm i gjerë nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kundër popullatës civile shqiptare në territorin e Komunës së Vushtrisë, dëbimin e popullsisë civile shqiptare nga

vendbanimet e tyre, përdorimin e dhunës fizike e psikike ndaj popullsisë, ndarjen e meshkujve dhe të rinjëve nga gratë fëmijët e pleqt duke i larguar me kamionë në drejtim të panjohur, si dhe veprime çnjerëzore, këtë gjykata në mënyrë të padyshimit e ka vërtetuar si nga dëshmia e të dëmtuarës-dëshmitare D.1, nga dëshmia e dëshmitarëve A. V. M. I. M. Xh. Sh. G. si dhe nga dëshmitarja D. B. të cilët me dëshmitë e tyre, vërtetuan se në Komunën e Vushtrrisë, gjatë vitit 1999, respektivisht gjatë muajit maj të atij viti, ndodhën sulme, të kohë pas kohshme, ngase u detyruan shumë herë të ndërrojnë vendqëndrimet e tyre, ose kur ishin të rrezikuar nga këmbësoria serbe ose të dëbuar nga vetë policia e ushtria serbe, me dëbimin e njerëzve nga shtëpia e tyre, me vënjën e flakës shtëpive, me plaçkitje, ku u merrnin telefonat, arin e të holla, e që të gjitha çfarë kishin u'a jepnin vetëm për të shpëtuar kokën e tyre apo të familjarëve. Dëshmitarët e vërtetuan se panë që para syve të tyre u vranë njerëz, (D.1 ka parë me sytë e saj kur është vrarë vozitësi i traktorit, kur në fshatin N. e B. e vranë një person duke ikur i cili nuk iu bind forcave për të hyrë në kolonë), panë njerëz të vrarë në rrugë, panë që i ndanin meshkujt, burrat – të rinjtë nga gratë, pleqt e fëmijët, të mbështetur për muri me duart lart, panë të akuzuarin duke rrahur me shkop pa përjashtim moshe, dëshmitarja D. në shtëpinë e K. P. pa gjymtyrë, vesh duar, këmbë, sy të nxjerrë, gishta si dhe u detyruan që të veprojnë nën urdhrat e policisë dhe ushtrisë serbe.

E dëmtuara D.1 dhe dëshmitarët, A. V. M. I. M. Xh. e D. B. ishin vet dëshmitar të këtyre ngjarjeve, ishin pjesë e këtyre sulmeve, dëbimeve, plaçkitjeve, ndarjeve të meshkujve dhe të rinjëve nga gratë, fëmijët e pleqt, ku e dëmtuara D.1, nuk dinte asgjë për burrin e saj, a ishte gjallë a vdekur, me të cilin ishin ndarë para datës 22 maj 1999, e me të cilin u takua vetëm pas përfundimit të luftës, e mbi të gjitha këtyre ngjarjeve e dëmtuara D.1. ishte edhe viktimë e dhunës seksuale si dhe motra e saj.

Këtë gjendje faktike të një sulmi të gjerë dhe sistematik nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe në territorin e Komunës së Vushtrrisë, e ka vërtetuar edhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.54/2017, i datës 25 maj 20218, ku i akuzuari për veprë penale të kësaj natyre edhe është në vuajtje të dënimit me burgim, e po ashtu është vërtetuar edhe me Aktgjykimin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë në Hagë. (Aktgjykimi :Rasti Djordjeviq nr.IT.-05-87/1-T, datë 23 shkurt 2011, Volumi II nga II).

Gjendjen faktike të dhunës seksuale të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, gjykata të njëjtën pa mëndyshje e ka vërtetuar, nga dëshmia e të dëmtuarës D.1, e cilla hollësisht ka përshkruar aktin e dhunimit, si u tërhoq për krahu në prezencë të nënës, vjehrrës dhe vajzave të vogla, se ishte i akuzuari Z. V. ai që e kreu aktin e dhunimit, emrin e të cilit e kishte dëgjuar për herë të parë nga personat që pritnin në radhë, e ai emër u përsërit nga kolegu i tij disa herë gjatë aktit të dhunimit.

Po ashtu kjo gjendje është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarës D. B. e cila ishte prezente kur të dëmtuarën e ndanë nga fëmiju të cilën e mbante në krah dhe e futën në dhomë, si dhe në bazë të gjendjes në të cilën e pa të dëmturën D.1 pasi që ishte kthyer në shtëpi.

E kjo gjendje padiskutueshëm u vërtetua edhe nga dëshmia e mjekëve A. V. dhe M. I. të cilët dëshmuar për gjendjen e rëndë të dëmtuarës D.1 me rastin e kontrollit mjekësor të saj në natën e ngjarjes të cilët i dhanë ndihmën mjekësore dhe e panë trupin e saj ku konstatuan lëndimet në

formë të hematomave, kafshimeve dhe gërvishjeve të shprehura në pjesën e gjinjve, shqyerje dhe skuqje në organin gjenital dhe gjakderdhje.

E kjo është vërtetuar edhe nga dëshmia e doktor Sh. G. i cili pas luftës e ka trajtuar të dëmtuarën D.1 si dhe nga mjekja dhe psikologja nga QKRMT V. D. dhe S. I.-Ç. ku e dëmtuara trajtohet nga kjo qendër dhe sipas psikologes çrregullimin e stresit postraumatik që e ka pësuar prej asaj ngjarje, edhe pse me kalimin e kohës me mbështetjen e familjes këto simptoma kanë pësuar ulje nga shifra 4 në 2 që është gjendja e saj aktuale, ende i ka prezente dhe se trauma e përjetuar ka ndikuar dhe vazhdon të ndikoj në mirëqenien e saj fizike dhe psikike dhe në funksionimin e saj personal dhe social, e që të gjitha këto dëshmi pa mëndyshje kanë vërtetuar se e dëmtuara ishte dhunuar, e të cilës tani më i është njohur edhe statusi nga Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës.

Këto ishin faktet e pakontestueshme të cilat gjykata i ka vërtetuar gjatë këtij procesi gjyqësor në këtë çështje penale, se e dëmtuara D.1 u dhunua, kurse aktin e dhunimit e kreu i akuzuari Z. V. të cilin e identifikoj vet e dëmtuara me emër dhe mbiemër se ishte ai, të cilin emër e kishte përmendur gjithëherë, që nga ajo ditë.

### **Vlerësimi i provave materiale:**

Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar si prova materiale, Procesverbalin mbi identifikim e personit përmes fotografisë nga dëshmitarja D.1 të datës 03.04.2018, raportet mjekësore të dëmtuarës dëshmitare D.1, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarës D. B. e datës 30.03.2018, Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitari M. Xh. i datës 17.07.2018, Fotoalbumi nga vendi i ngjarjes dhe skicimi i vendit të ngjarjes të datës 24.04.2018, shkresat për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 08.11.2018, shkresa e Malit të Zi datë 09.03.2019, kërkesa e PSRK-së për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 07.08.2019, Urgjencë e PSRK për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 25.09.2019, shkresa e MD me numër 04/2-2473-K/16 e datës 24.10.2019 si dhe shkresa me të cilën Komisioni Qeveritar pëe njohjen dhe Verifikimin e Statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Qlirimtare të Kosovës, të dëmtuarës, dëshmitare D.1 i është njohur statusi me datë 24.08.2018.

Gjykata analizoi të gjitha provat materiale dhe faktet vendimtare të provuara nga ato prova, duke paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë arsyet për të gjitha ato fakte vendimtare dhe nga vlerësimi i të njëjtave vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga, Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitarja D.1 e datës 03.04.2018, gjykata ka vërtetuar se procesi i identifikimit është bërë komfor dispozitave ligjore, ku e dëmtuara në mesin e personave gjatë procesit të identifikimit e njohu të akuzuarin Z. V. në mesin e fotografive të tjera dhe ka bërë edhe përshkrimin fizik të personit që e ka kryer akin e dhunimit.

Nga raportet mjekësore të dëmtuarës D.1 u vërtetua pa diskutueshëm gjendja faktike se e dëmtuara në muajin shtator të vitit 1999, respektivisht pas 4 muajve të dhunës seksuale, kishte qenë e shtrirë në Klinikën Obstetrike - Gjinekologjike në Prishtinë, nga data 22.09.1999 deri me 29.09.1999, si dhe nga raportet mjekësore konstatohet se e njëjta ka dhimbje të shpinës dhe këmbës, kurse nga raporti i datës 03.03.2016, është konstatimi se sëmundja i ka filluar para 15 viteve dhe se i është

nënshtuar edhe intervenimit kirurgjik, e që kjo periudhë kohore lidhet me kohën e sulmit ndaj saj, të cilin fakt e dëmtuara D.1 ka dëshmuar se gjatë aktit të dhunimit kishte marrë një goditje të fortë me shkëlqim nga i akuzuari në kurriz nga e cila goditje kishte humbur vetëdijen, ku akoma ndien pasojat e asaj goditje.

Nga, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarës D. B. e datës 30.03 2018, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit ku dëshmitari e saj ishte identike dhe në përputhshmëri të plotë me dëshminë e të dëmtuarës D.1 dhe të dëshmitarëve A. V. M. I. dhe M. Xh. si dhe me provat materiale.

Nga, Procesverbali mbi identifikimin e personit përmes fotografisë nga dëshmitari M. Xh. i datës 17.07.2018, është vërtetuar se në mesin e personave të prezantuar përmes fotografive, dëshmitari ka identifikuar të akuzuarin Z. V. për të cilin tha se e kishte njohur mirë dhe nuk e ka pasur problem identifikimin e tij.

Nga, prova materiale, fotoalbumi nga vendi i ngjarjes dhe skicimi i vendit të ngjarjes të datës 24.04.2018, tregohet vendi ku ishte shtëpia e R. dhe M. Xh. ku ishin grumbulluar mijëra qytetar të Vushtrrisë të cilët paraprakisht u dëbuan dhe shtëpitë e tyre dhe i detyruar të pritnin në radhë për tu regjistruar dhe për tu pajisur me kartela të identifikimit, vendi ku e dëmtuara u dhunua nga i akuzuari.

Nga, shkresat për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 08.11.2018, shkresa e Malit të Zi të datës 09.03.2019, kërkesa e PSRK-së për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale datë 07.08.2019, Urgjencë e PSRK për dhënien e pëlqimit për ndjekje penale të datës 25.09.2019, shkresa e MD me numër 04/2-2473-K/16 e datës 24.10.2019, të gjitha këto dëshmi vërtetojnë faktin se i akuzuari i ishte nënshtuar procedurës së Ekstradimit nga shteti kërkues i Republikës së Kosovës, në shtetin e Malit të Zi, për ekstradimin e Z. V. për veprën penale, Krime lufte, për ngjarjet në fshatrat Studime e Poshtme dhe e Epërme të Komunës së Vushtrrisë dhe për ngjarjet në Burgun e Smrekovnicës dhe autoritetet e Malit të Zi, e kanë ekstraduar të njëjtin për në Republikën e Kosovës, ku ishte edhe pikërisht publikimi i këtij lajmi që e dëmtuara filloj të kërkoj drejtësi, për krimin e kryer ndaj saj.

Është e vërtetë se pasi që i akuzuari është ekstraduar në Kosovë, autoritetet e Malit të Zi, janë njoftuar përmes rrugës zyrtare me Aktvendimin për fillimin e hetimeve për të akuzuarin edhe për veprën penale, Krime lufte, respektivisht për veprën penale të kryer me 22 maj 1999 te varrezat e Vushtrrisë, ndaj të dëmtuarës D.1., për çka Autoritetet e Malit të Zi kanë dhënë pëlqimin që mund të zhvillohet procedura penale edhe për veprën penale, andaj me këto prova materiale, që kanë të bëjnë lidhur me procedurën e ekstradimit, gjykata vlerëson se është vepruar Komfor Ligjit për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar.

Nga shkresa e siguruar nga Komisioni Qeveritar për njohjen dhe Verifikimin e Statusit të personave të dhunuar gjatë Luftës Qlirimtare të Kosovës, u vërtetua se zyrtarisht të dëmtuarës D.1 i është njohur statusi i personit të dhunuar me datë 24.08.2018.

**Vlerësimi i pretendimeve të mbrojtës së të akuzuarit në fjalën përfundimtare dhe gjetjet e gjykatës:**

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar gjithashtu edhe pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarit Z. V. avokatit N. V. se aktakuza është ngritur kundërligjshëm, në mënyrë paushalle, pa asnjë provë dhe e njëjta nuk është dashur të jetë çështje e gjykimit, por të hudhet, këtë pretendimin, gjykata e hodhi si ta pazuar, ngase aktakuza nuk është ngritur kundërligjshëm dhe paushalle, por komfor dispozitive të procedurës penale dhe e mbështetur në prova të pranueshme për gjykatën, e që mbi bazën e tyre edhe është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet qenësore të veprës penale e cila i vihet në barrë.

Mbrojtja pretendon se konstatimi i cekur në dispozitivin e akuzes në mënyrë të paligjshme “me qëllim të dhunimit, si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik ndaj gruas së nacionalitetit shqiptar“, për këtë nuk ka asnjë provë dhe konstatimi i tillë i prokurorisë nuk e konfirmon asnjë gjykim në asnjë gjykatë në Kosovë, është qëllim keq sepse të pandehurin e vë në pozitë më të vështirë se që është, ky pretendimin i tillë i mbrojtës nuk qëndron, për faktin se ndodhi një sulm i gjerë dhe sistematik në Komunën e Vushtrrisë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjykata mbi bazën e të gjitha provave të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor si të atyre personale ashtu edhe atyre materiale dhe një konstatim të tillë e vërteton edhe aktgjykimi i gjykatës Themelore në Mitrovicë si dhe aktgjykimi nga tribunali penal Ndërkombëtar në Hagë për ish Jugosllavinë, ndërsa se kishte dhunë ndaj gruas shqiptare kjo u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarës të dëmtuar D.1, e cila ka dëshmuar se u dhunua nga i akuzuari, se edhe motra e saj u dhunua prej shumë personave, se në dhomën ku u dhunua D.1 sipas saj ishin edhe 5 femra të tjera të cilat po ashtu dhunoheshin nga polic të shumtë në mënyrën më brutale, nga dëshmia e nënës së saj se dy vajzat e saj ishin dhunuar, që të dyja këto dëshmitare kanë dëshmuar se kanë parë se si janë marrë femra të reja të cilat kur janë kthyer ishin gjendje të rëndë. Po ashtu këtë fakt e ka vërtetuar edhe dëshmia e dëshmitarit Sh. G. i cili vet i kishte trajtuar 3-4 raste të dhunimit gjatë së kohës së luftës dhe se të njëjtit i kishin rrëfyer edhe dy dëshmitar okular (tani të dy të ndjerë), se vajzat e tyre ishin dhunuar nga i akuzuari Z. V. dhe se të gjitha ato femra dhe vajza – gra ishin shqiptare se të gjitha këto dhunime ndodhën pikërisht gjatë periudhës së luftës, andaj edhe gjykata është mbështetur vetëm në provat dhe dëshmit që inkriminojnë veprimet e të akuzuarit.

Pretendimin e mbrojtës se ky ishte rasti i parë i dhunës seksuale pa prova, është i paqëndrueshëm dhe i paargumentuar, ngase provë e drejtëpërdrejtë ishte dëshmia e vet të dëmtuarës D.1, e cila si në polici, prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor ka përshkruar në hollësi veprimet inkriminuese të të akuzuarit, e cila ka bërë përshkrimin e tij, mënyrën se si e kuptoj emrin e tij, se e njohu përmes fotografisë duke bërë edhe identifikimin e tij, të cilin e identifikoj edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu edhe të gjitha dëshmitë dhe provat e administruara nga ana e gjykatës në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë vërtetuar se i akuzuari me datën 22 maj të vitit 199 ka qenë tek varrezat, është parë tek shtëpia e R. Xh. e dëmtuara dëshmoj se ai i ndihmuar edhe nga një polic tjerë e dhunoi andaj edhe mbi të gjitha këtë fakte dhe dëshmi u vërtetua se i akuzuari kreu aktin e dhunimit ndaj gruas shqiptare, në mënyrë brutale i ndihmuar edhe nga një polic deri më tani i paidentifikuar dhe në prezencën edhe të femrave tjera shqiptare të cilat po ashtu dhunoheshin në të njëjtin vend dhe se ishte e qartë se në atë grumbull të popullatës të gjithë ishin të nacionalitetit shqiptar dhe civil.

Po ashtu, mbrojtja pretendon se nuk mund të argumentohet se si pasojë e aktit të dhunës së shkaktuar nga i mbrojturi i tij e dëmtuara D.1, ka pësuar pas 4 mujash abort, ngase lidhja shkakore

me pasojën nuk ekziston, se asnjë prove nuk e dëshmon se si pasoje e aktit seksual e dëmtuara ka abortuar, gjykata vlerëson se ky pretendim i mbrojtës nuk qëndron, ngase edhe përkundër asaj se nuk ka një ekspertizë apo provë, që e vërteton shkaku të abortit, është fakt i pakontestueshëm se me datën 22 maj të vitit 1999 e dëmtuara D.1 u dhunua nga i akuzuari, ngase lëndimet e shkaktuara në trupin e saj e vërtetuan këtë fakt, e cila në atë kohë edhe ishte shtatëzanë, e po ashtu është i pakontestueshëm edhe fakti se me datë 22 shtator të atij viti 1999 e njëjta ka pësuar abort dhe ka humbur fëmijët e saj binjak dhe këto janë dy fakte të pakontestueshme.

Pretendimi i mbrojtjes, se vepra penale nuk mundet të kualifikohet apo të dënohet sipas kodit të ri penal i cili është më i rëndë, të akuzuarit i vihet në barrë që ka kryer vepër penale Krimet e luftës kundër popullsisë civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së, këtë pretendim të mbrojtës gjykata e ka vlerësuar dhe se ky pretendim i mbrojtës është i bazuar dhe se gjykata ndaj të akuzuarit ka aplikuar ligjin penal i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa pavarësisht faktit se kjo vepër penale është e ndëshkueshme edhe me kodin penal aktual në fuqi dhe se kodi aktual është më i pafavorshëm për të akuzuarin, por gjykata është kujdesur sipas detyrës zyrtare që ndaj të akuzuarit të aplikoj ligjin i cili është më i favorshëm për të akuzuarin e që rrjedhimisht është Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i cili kod ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Pretendimi i mbrojtjes se udhëheqja e më shumë procedurave për krime lufte është e palejueshme, ngase për të akuzuarin janë duke u udhëhequr 4 procedurave penale, të njëjtin pretendim gjykata ka vlerësuar, por mbi bazën e asaj se jo të gjitha procedurat penale ishin në stadin e njëjtë të procedimit, ndaj tij ka edhe rast të kthyer në rigjykim dhe me palë të dëmtuar tjerë e të cilat çështje edhe janë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, kurse në këtë çështje penale kishin një të dëmtuar dëshmitare me urdhër për masë mbrojtëse në mënyrë që mos të zbulohet identiteti i të dhënave të saj për shkaqe morale, andaj edhe kishim një gjykim të mbyllur për publikun dhe se është trajtuar ndaras procedurave tjera penale.

Mbrojtja pretendon se propozimi i provave në shqyrtimi gjyqësor e jo në aktakuzë nuk është i lejuar ku Prokurorja në fund të shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që të administrohen si prova që në aktakuzë nuk i ka përmend asnjë, ndërsa mund të propozohen vetëm prova të reja që deri më atëherë nuk ishin të ditura, kurse të gjitha provat e propozuar nga prokurorja ishin të ditura. Këtë pretendim të mbrojtjes gjykata e ka vlerësuar si të pambështetshëm, për faktin se provat e propozuara nga Prokurori në seancën e shqyrtimit gjyqësor, sikurse për gjykatën, po ashtu edhe për mbrojtjen dhe të akuzuarin si dhe përfaqësuesën e palës së dëmtuar nuk ishin prova të reja, ishin prova të cilat i janë vënë në dispozicion mbrojtësit, të akuzuarit dhe të gjitha palëve dhe është bërë zbulimi i tyre me kohë, ngase të gjitha palët ishin të pajisura me të gjitha ato shtresat të lëndës dhe nuk kishte asnjë provë të re për çka edhe mbrojtja vet e ka potencuar, përveç Shkresës nga Komisioni Qeveritar e cila ka të bëjë se dëmtuara D.1 ka fituar statusin e të dhunuarës, kurse të gjitha provat e tjera ishin të ditura, ishin pjesë e shkresave të lëndës, por vetëm një gabim teknik i bërë nga ana e prokurorisë kjo i shërbeu mbrojtjes që i njëjti këto prova ti propozoj të shpallën të paparueshme, ngase nuk lejohet një gjë e tillë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, mirëpo gjykata ka lejuar dhe ka bërë administrimin e tyre për arsyen e njëjtë dhe të vetme se nuk ishin prova të reja por ishin ato që i kishin të gjitha palët dhe ishin të zbuluara me kohë dhe se me administrimin e këtyre provave në asnjë mënyrë nuk është vështirësuar apo rënduar gjendja e të

akuzuarit sipas pretendimit të mbrojtjes, ngase pikërisht mbi bazën e të njëjtave është ngritur akti akuzues.

Mbrojtja po ashtu pretendon se është shkelur Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, ngase është proceduar pa prova, pasi që provat u administruan në fund të shqyrtimit gjyqësor, por pretendimin e tillë të mbrojtjes gjykata e ka vlerësuar se provat ishin pjesë e shkresave të lëndës ato ishin të ditura, të njëjtat i kishte edhe mbrojtja edhe i akuzuari dhe pas seancës së shqyrtimit fillestar mbrojtësi i ka propozuar gjykatës hedhjen e aktit akuzues sepse ekzistojna rrethana që e pengojnë ndjekjen penale pikërisht për këtë arsye, se është shkelur Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, e që Gjykata me Aktvendim PS.nr.15/20, të datës 07.08.2020 e ka hudhur pretendimin e mbrojtës si të pa bazuar, ngase nuk është shkelur procedura e ekstradimit për të akuzuarin, për faktin se edhe pse i akuzuari ishte ekstraduar për vepër tjetër, pasi që janë njoftuar autoritetet e Malit të Zi lidhur me dyshimin e bazuar se i akuzuari, dyshohet edhe për vepër penale si dhe janë njoftuar me Aktvendimin për fillimin e hetimeve, Mali i Zi ka dhënë pëlqimin edhe lidhur me këtë vepër penale të cilin pëlqim e ka pranuar PSRK-ja andaj, edhe ka filluar procesi gjyqësor ndaj të akuzuarit dhe është në përputhje me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Penale, respektivisht është në përputhje me nenin 36 të atij Ligji, ku thuhet, “Personi i ekstraduar në Kosovë nuk do të ndiqet penalisht ose dënohet për asnjë vepër penale të kryer para dorëzimit të tij/saj përveç veprës penale për të cilën është lejuar ekstradimi, *përgjashtimisht kur shteti i lutur pranon*, e që në këtë rast shteti i lutur ka dhënë pëlqimin dhe ka pranuar.

Mbrojtja pretendon se nuk ka prova se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale, se është vetëm e dëmtuara kurse prokuroria nuk ka asnjë dëshmitar që e vërtetojnë se e dëmtuara ishte aty e cila ka përsëritur se në shtëpi ka hy me nënën, vjehrrën dhe motrën Sevdije e asnjë nuk janë dëgjuar, kurse dy mjekët të cilët të dëmtuarës i ofruan ndihmën mjekësore, nuk ishin dëshmitar të ngjarjes dhe përveç gjendjes së pacientit nuk kanë çka të flasin, nuk i kanë bërë kontroll gjinekologjike se nuk ishin të asaj lamie. Këtë pretendim të mbrojtjes se i akuzuari Z. V. akuzohet pa prova nuk qëndron dhe është i paargumentuar, ngase ishte dëshmia e drejtëpërdrejtë e të dëmturës D.1. e cila ka dëshmuar se si e kanë futur brenda në katin e dyte, e dhunoi i akuzuari që deri më atë ditë se kishte njohur kurrë, nuk i dinte emër as mbiemër, por e mësoj emrin e tij prej njerëzve të cilët e njihnin shumë mirë se kush ishte dhe ai emër edhe iu përsërit disa herë nga kolegu i të akuzuarit ai i cili edhe abuzoj me të seksualisht që i ndihmonte e që e kishte thirrë disa herë me emër, e fakte të pakontestueshme ishin gjurmët e dhunës dhe lëndimet e pësuar fizike dhe psikike në trupin e saj që e vërtetuan vet mjekët.

D.1, është plotësisht e vërtetë se ka dëshmuar se së bashku me të ishte nëna dhe vjehrra, që e kanë parë derisa i akuzuari e ka tërhequr dhe e ka dërguar në dhomën lartë, por vjehrra e saj tani më nuk jetonte dhe nuk ka dhënë asnjë dëshmi më parë, kurse nëna e saj e cila është gjallë në cilësi të dëshmitares është dëgjuar në polici me autorizim të prokuroit dhe e njëjta ka përshkruar për gjendjen kur i janë marrë vajzat e saj dhe me pas kur janë kthyer në shtëpi, pas dhunimit në ç’gjendje tmerruese ishin kthyer, të lënduara me shenja të kafshimit, hematomeve, gati të zhveshura dhe në gjendje tejet të rëndë, e po ashtu është e vërtetë se dëshmitarja D. nuk ka dëshmuar se vajzën e saj e ka dhunuar, Z. V. ngase e njëjta shumë drejt ka sqaruar se nuk e dinte kush ia morri vajzat, nuk i kishte shikuar personat, policët e ushtarë serb, ngase kishte frike për vajzat e saj të cilat ishin të moshës së re, para se ato t’ia merrnin, andaj edhe e njëjta në asnjë mënyrë nuk e ka inkriminuar të akuzuarin si kryes të veprës penale, dhe se nuk e dinte se kush është kryesi.



Por dëshminë e D.1, të besueshme dhe bindëse se e njëjta është dhunuar e kanë argumentuar mjekët A. V. dhe M. I. me dëshmitë e tyre, të cilët natën kritike i ofruan ndihmën mjekësore, e kontrolluan dhe konstatuan se në trupin e saj kishte hematome, kafshime, gervishje, në pjesën e sipërme –gjoks, qafe, shqyerje dhe gjakdrejdhje tek organet gjenitale.

Është apsolutisht e vërtetë se mjeket ishin specialist të mjekësisë familjare, nuk ishin gjinekolog, nuk i bënë kontroll gjinekologjike ngase nuk ishin të thirrur për atë specializim, nuk kishin as pajisje, por me përshkrimin e gjendjes së të dëmtuarës dhe lëndimeve në trupin e saj, kjo ishte më se bindëse dhe e mjaftueshme se e njëjta ishte dhunuar, e fare është e qartë se ishte koha e luftës dhe ishin të rrethuar dhe në ato rrethana duke iu pamundësuar edhe kontroll gjinekologjike, andaj pretendimin se pa prova është akuzuar është krejt i paqëndrueshëm.

Mbrojtja, po ashtu pretendon se identifikimi nuk ka asnjë kuptim, pasi që kur i akuzuari është arrestuar është publikuar fotoja e tij dhe mbi atë bazë edhe është njohur, e që ky pretendim i mbrojtjes po ashtu nuk qëndron, gjykata ka vërtetuar faktin se e dëmtuara çdo here e kishte përmendur të akuzuarin me emer dhe mbiemër, kishte bërë përshkrimin e tij të saj kohe, e të cilin e njohu edhe në sallën e gjyqimit dhe sipas të dëmtuarës nuk e njohu fotografinë e të akuzuarit por vet të akuzuarin, të cilin e njohën edhe dëshmitarët dhe nuk ishte problem për ta ngase e kishin njohur shumë mirë edhe më parë.

Për pretendimin e mbrojtjes, se nuk dihet se për cilën grua folën dëshmitarët, të cilët ju referuan, me “ajo, gruaja, pacientja, një grua”, gjykata këtë pretendim të mbrojtjes e vlerëson si ta paargumentuar, për faktin se të gjithë dëshmitarët janë udhëzuar dhe paralajmëruar nga gjykata për detyrimet e tyre, i ka njoftuar lidhur me anonimitetin e dëshmitarës e cila kishte pseudonimin D.1 dhe të njëjtës mund ti referohen si ta kenë më të lehtë dëshmitarët, por vetëm të kenë kujdes në zbulimin e emrit të saj, pra në ruajtjen e konfidencialitetit dhe se kjo është bërë në prezencën e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, e që edhe mbrojtja e ka dëgjuar këtë udhëzim, të gjithë dëshmitarët ishin në dijeni se për cilën grua po dëshmonin dhe se pretendimi mbrojtjes ishte i ekzagjeruar, edhe për faktin se e dëmtuara kur ka dhënë dëshminë e saj në polici dhe në prokurori ka dhënë me emer e mbiemër, të gjithë dëshmitarët kur u janë marrë dëshmitë e tyre, në polici apo në prokurori ishin në dijeni për emrin e të dëmtuarës, edhe vet i akuzuari dhe mbrojtësi ishin në dijeni për emrin e gruas, ku i akuzuari është marrë në pyetje edhe pse i njëjti ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mbrohet në heshtje, ngase kërkesa për masa mbrojtëse për dhënien e anonimitetit të dëmtuarës dhe vendimi i gjykatës lidhur me këtë kërkesë është bërë pikërisht pasi që ishin dëgjuar të gjithë, e dëmtuara D.1, të gjithë dëshmitarët si dhe i akuzuari dhe me pseudonimin D.1, e njëjta ishte vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj të gjithë e kishin shumë të qartë se për cilën grua po bëhej fjalë.

Rrjedhimisht të gjitha pretendimet e mbrojtës gjykata i vlerësoi të njëanshme dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave sa më të mira dhe zhveshjen e të akuzuarit nga përgjegjësia penale, andaj pretendimeve të tilla të mbrojtjes nuk ua fali besimin.

I akuzuari në asnjë fazë të procedurë penale nuk ka dhënë mbrojtjen e tij, ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që të mbrohet në heshtje, por gjatë fjalës hyrëse dhe në fund të fjalës përfundimtare vetëm është mbrojtur se ndihet i pafajshëm, se ndaj tij mund të ngriten jo një por 33 aktakuza dhe se nuk

e ka kryer veprën penale dhe se dëshmitarët të cilët janë dëgjuar para gjykatës nuk janë dëshmitar nga dora e parë, direkt nuk e kanë parë ngjarjen e cila ka të bëjë me akuzën, por janë vetëm dëshmitar të cilët kanë folur fjalët që i kanë dëgjuar prej të tjerëve dhe në seancën e datës 01 mars 2021 edhe ka propozuar që të përjashtohen ata dëshmitar nga procesverbalet, përveç dëshmitares D.1, të cilës i kishte parashtruar një pyetje nëse ka bërë kontroll gjinekologjike, e që gjykata edhe nga vet pyetja e të akuzuarit dhe propozimi i tij që përveç të dëmtuarës të tjerët të përjashtohen ngase nuk ishin dëshmitar që e kanë parë ngjarjen, por që kanë dëshmuar vetëm me fjalët e të tjerëve edhe kjo bien në përputhshmëri të plotë me dëshminë e të dëmtuarës se është e vetmja dëshmi e drejtëpërdrejtë që e inkriminon të akuzuarin, ngase dëshmitë e të tjerëve vetëm i vërtetojnë dhunën e cila ka pësuar pas aktit seksual, ngase është e qartë se në atë dhomë ku u krye akti i dhunimit, nuk ishin të tjerët dhe konstatimi i të akuzuarit, se nuk e ka kryer veprën penale, nuk e përjashtoj nga përgjegjësia penale, ngase të gjitha provat dhe dëshmitë vërtetojnë se ishte i akuzuari ai i cili ka kryer veprën penale të dhunimit ndaj D.1.

Gjykata ua fali besimin në tërësi dëshmisë së të dëmtuarës D.1, dëshmia e së cilës ishte e drejtëpërdrejtë, e qartë, e sinqertë dhe bindëse, e cila ishte dëshmi objektive dhe po ashtu në përputhshmeri të plotë edhe me dëshmitë e dëshmitarëve dëshmitë e të cilëve u shtelluan më lartë, si dhe me provat materiale.

### **Vlerësimi ligjor i veprës penale:**

Vepra penale, Krime e luftës, kush duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose të okupacionit urdhëron që kundër popullsisë civile të bëhen vrasje, tortura, sjellje çnjerëzore, eksperimente biologjike, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha ose cenime të integritetit trupor apo shëndetit....nga neni 142 të KPtë RSFJ, ku nga përkufizimi i këtij neni, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari Z.V. me dashje dhe me vetëdije të plotë e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e duhura që kanë formësuar tiparet objektive dhe subjektive të figurës së vepres penale Krime lufte, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Janë përmbushur, tiparet e veprës penale, për faktin se vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari Z.V. është kryer me datë 22 maj 1999, gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur (ku para fundit të majit 1998 ekzistonte konflikti i armatosur në Kosovë në mes të forcave Serbe dhe UÇK-së), ndërsa pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, me datë 24 mars 1999 Republika Federative e Jugosllavisë kishte shpallur gjendjen e luftës që ishte shtrirë në territorin e Kosovës deri me datë 19 qershor 1999, andaj i akuzuari ishte i vetëdijshëm për ekzistimin konfliktit të armatosur meqë ishte pjesëtar i njësisë rezervë të policë Serbe në kohën kur Republika e Serbisë kishte shpallur gjendjen e luftës andaj edhe ekziston lidhje midis aktit kriminal dhe konfliktit të armatosur dhe se i njëjti me vetëdije dhe me dashje ka dhunuar gruan shqiptare në formë tejet të egër dhe poshtëruese, duke i shkaktuar pasoja të rënda fizike dhe psiskike.

Andaj, gjykata pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, se veprën penale e ka kryer me dashje direkte dhe në bashkëkryerje, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin e parapar ligjor të precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### **Vendimi mbi dënimin:**

Gjykata gjatë shqiptimit të dënimit, mori në konsideratë dhe vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 41 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjatë vendosjes për dënimin, gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe gjeti se i akuzuari i cili ishte nëpunës i gjykatës në Vushtrri, gjatë periudhës së konfliktit të armatosur ishte rezervist i policisë Serbe dhe me dashje dhe vetëdije të plotë e ka kryer veprën penale në bashkëkryerje edhe me pjesëtar tjerë të forcave serbe, gjykata e ka vlerësuar motivin e kryerjes së veprës penale dhe cenimin e viktimës së mbrojtur, ku u vërtetua se i akuzuari veprën penale e ka kryer ndaj gruas – viktimës së nacionalitetit shqiptar (person i mbrojtur) kurse në rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, kjo ishte e lidhur qartë me situatën e krijuar nga konflikti i armatosur që ishte duke u zhvilluar, po ashtu sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, këtë e kanë vërtetuar e dëmtuara D.1 dhe dëshmitarët se i akuzuari kishte sjellje brutale ndaj popullatës civile shqiptare duke i sulmuar fizikisht me shkop druri dhe sjelljet e tij janë vërtetuar edhe me aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku i akuzuari për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të pafundme përmes shkaktimit të rrahjeve, shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit tani gjendet në vuajtje të dënimit dhe mbështetur mbi këto arsye, gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin, por vetëm rrethana rënduese. Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor për këtë vepër penale, sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj tij do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga këto veprime / kryerja e veprave penale.

### **Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale :**

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata të dëmturën D.1, përmes përfaqëuses së saj me autorizim e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridik – civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale (paushallin gjyqësor) sa i përket të akuzuarit për të cilin është dhënë aktgjykim dënues është marrë në harmoni me nenin 450, 451, 452 dhe 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi kompenzimin e viktimave të krimit, gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit për Komensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.05/L-036).

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI SPECIAL  
PS.nr.15/2020 datë 05 korrik 2021**

**Zyrtare Ligjore,  
Arbnore Idrizi**

**Kryetarja e Trupit Gjykes,  
Valbona Musliu-Selimaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit – Departamentit Special, nëpërmjet kësaj gjykate.